



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-23

PËR SHËRBIMET E SHOQËRISË INFORMATIKE

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, Kreut 5.1 (h) dhe 9.1.26 (a), me qëllim të harmonizimit, të rregullativës ligjore me të arriturat e sistemit informativ-elektronik, standardet ndërkombëtare, zhvillimit, funksionimit, ngritjes së cilësisë dhe sigurisë në fushën e shërbimeve të shoqërive informatike,

Miraton:

LIGJIN PËR SHËRBIMET E SHOQËRISË INFORMATIKE

PJESA I TREGTIA ELEKTRONIKE NË PËRGJITHËSI

Kapitulli I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1.1. Me anë të këtij ligji, dokumentacioni në formë elektronike do të jetë juridikisht i barabartë me dokumentacionin tradicional të paraqitur në format të letrës, për të lehtësuar veprimtaritë komerciale që përfshijnë, por që nuk kufizohen në shitblerje që bëjnë konsumatorët nëpërmjet internetit-eTregtia, shërbimet elektronike bankare dhe ato financiare ePagesa, ofrimin e shërbimeve qeveritare eQeveria, blerjen në formë elektronike nga ndërmarrjet eProkurimi. Ky ligj bazohet në ligjin model të hartuar nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Ligjin e tregtisë ndërkombëtare-UNCITRAL.

1.2. Ky ligj zbatohet për cilindo lloj informacioni dhënë në formën e mesazhit të të dhënave, përveç situatave, si vijon:

- a) kontratat që krijojnë ose transferojnë të drejtat për pasurinë e patundshme, përveç së drejtave të qirasë;
- b) kontratat që me ligj kërkojnë përfshirjen e gjykatave, të autoriteteve publike ose të atyre profesionale që ushtrojnë autoritet publik;
- c) kontratat për garancinë e dhënë dhe për sigurimet kolaterale dhënë nga personat që veprojnë për qëllime jashtë fushës së tyre tregtare, të biznesit ose të profesionit;
- d) kontratat që rregullohen me Ligjin familjar ose me Ligjin për trashëgiminë

1.3. Ky ligj nuk cenon asnjë dispozitë ligjore që ka si qëllim mbrojtjen e konsumatorit.

Neni 2 Përkufizime

Termat në vazhdim, qoftë në njëjës apo në shumës do t' kenë këto kuptime:

“**Marrësi**” i mesazhit të dhënave nënkupton personin që synohet dhe cilësohet si marrës i mesazhit të dhënave nga autori i mesazhit, mirëpo nuk përfshin personin që vepron si ndërmjetësues në lidhje me mesazhin e të dhënave.

“**Thirrje**” nënkupton lidhjen e krijuar me mjetet e shërbimeve publike telefonike në dispozicion, ku mundësohet komunikim i dyanshëm në kohë reale.

“**Komerciale**” nënkupton të gjitha çështjet që rrjedhin nga raportet e natyrës komerciale qoftë ato të kontraktuara apo të pa kontraktuara. Raportet e natyrës komerciale përfshijnë por nuk kufizohen me transaksionet si vijon:

- a) ndonjë transaksion tregtar për furnizim ose shkëmbim mallrash dhe shërbimesh;
- b) marrëveshjet e shpërndarjes;
- c) përfaqësimi komercial ose i agjencisë;
- d) faktoring;
- e) dhënie-marrje me qira;
- f) punët e ndërtimit;
- g) këshillimin;
- h) inxhinierinë;
- i) licencimin;
- j) investimin;
- k) financimin;
- l) veprimet bankare;
- m) sigurimin;
- n) marrëveshjen e shfrytëzimit ose të koncesionit;
- o) sipërmarrjen e përbashkët dhe format e tjera të bashkëpunimit industrial ose të biznesit;
- p) transportin ajror, detar, hekurudhor dhe rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve.

“**Komunikim**” nënkupton çdo shkëmbim ose bartje informacioni ndërmjet numrave të caktuar të palëve me mjeteve të shërbimeve publike elektronike në dispozicion. Kjo nuk përfshin ndonjë informatë të bartur si pjesë e një shërbimi transmetues për publikun nëpërmjet rrjetit të komunikimit elektronik, përveç nëse informacioni ka të bëjë me palën, si klient, abonent, regjistruar te identifikueshëm ose shfrytëzuesin (përdoruesin) që merr informacionin.

“**Pëlqimi**” nga përdoruesi ose parapaguesi i korrespondon pëlqimit të subjektit të të dhënave sipas Direktivës evropiane 95/46/EC.

“**Pëlqimi i subjektit të dhënave**” nënkupton çdo tregues- indikacion të kuptueshëm dhe specifik, i dhënë me vullnet të lirë me anë të cilave subjekti i të dhënave bie dakord që marrëveshja për të dhënat personale të tij të jenë përpunuar.

“**Konsumator**” nënkupton mbajtësin e kartelës kreditore ose debitore lidhur me pagesat elektronike.

“**Kontrollor**” nënkupton personin fizik ose juridik, autoritetin publik, agjencinë ose ndonjë tjetër entitet që si i vetëm ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mjetet e përpunimit të dhënave personale.

“Mesazhi i të dhënave” nënkupton informacionin e krijuar, dërguar, pranuar ose të ruajtur me mjeteve elektronike, optike ose të ngjashme, duke përfshirë, por jo i kufizuar në shkëmbimin elektronik të dhënave (SHEDH), postën elektronike, telegramet, teleksat ose telekopjet.

“Shkëmbimi elektronik i të dhënave-SHEDH ” nënkupton transferimin elektronik të informacionit nga kompjuteri në kompjuter duke shfrytëzuar standardet e pajtueshme për sajimin e informacionit.

“Posta elektronike” nënkupton çfarëdo mesazhi në formë teksti, zërit, tingullit ose imazhi, të dërguar me anë të rrjetit të komunikimit elektronik publik që si i tillë mund të ruhet në rrjet ose në pajisjen e fundme të marrësit deri në momentin kur merret nga pranuesi -marrësi.

“Pagesa elektronike” nënkupton çfarëdo transaksioni pagese të kryer me anë të kartelës që përmban pjesën magnetike, mikrokroçarqeve ose çelësin biometrik që shfrytëzohet në терминаlet elektronike të pagesave -TEP ose në терминаlet e pikës shitëse -PSH. Ky ligj nuk përfshin:

- a) kartelat ‘specifike të kompanisë’ që nuk mbulohen nga përkufizimet e mësipërme;
- b) kartelat që u shërbejnë qëllimeve të ndryshme nga pagesa e drejtpërdrejtë ose të vonuara
- c) pagesat me çek të garantuar nga kartelat bankare;
- d) pagesat me kartelë ku shfrytëzohen proceset mekanike -(mbetja e faturës).

“Sistemi i informacionit” nënkupton sistemin e sajimit, të dërgimit, marrjen, ruajtjen ose edhe përpunimin e mesazheve të të dhënave.

“Ndërmjetësues në lidhje me ndonjë mesazh të veçantë të dhënave” nënkupton personin që në emër të ndonjë personi tjetër dërgon, merr ose ruan mesazhin e të dhënave ose siguron shërbime tjera që lidhen me atë mesazh të të dhënave.

“Ndëroperimi” nënkupton çështjet shtetërore, ku sistemi i kartelës, i lëshuar në një shtet anëtar dhe/ ose që i takon sistemit të dhënë të kartelës, mund të shfrytëzohet nga shtetet e tjera anëtare dhe/ ose në rrjetet e instaluara nga sistemet e tjera. Kjo kërkon që kartelat dhe lexuesit e tyre e që shfrytëzohen në sistemet e ndryshme, duhet të jenë në përputhje teknologjike dhe ato sisteme duhet të jenë të hapura dhe të mbështetura me marrëveshje të ndërsjella.

“Lëshuesi” nënkupton çdo institucion publik bankar apo kreditues që lëshon kartelë pagese për shfrytëzim, prodhim apo shërbim elektronik.

“Të dhënat për vendin” nënkupton çdo të dhënë të përpunuar në rrjetin elektronik të komunikimit ku tregohet vendndodhja e pajisjes fundore në dispozicion të përdoruesit të shërbimit elektronik publik të komunikacionit.

“Autori” i mesazhit të dhënave nënkupton personin nga i cili ose në emër të cilit është dërguar mesazhi i të dhënave ose është krijuar ky mesazh, para se të ruhet - nëse ka ndonjë të tillë-, por që nuk përfshinë personin që vepron si ndërmjetës në lidhje me atë mesazh të dhënave.

“Të dhënat personale” nënkuptojnë çdo informacioni që ka të bëjë me personin fizik të identifikuar ose që mund të identifikohet “subjekti i të dhënave”; personi që mund të identifikohet është person që mund të identifikohet direkt ose indirekt, në mënyrë të

veçantë, duke u mbështetur në numrin identifikues ose me një a më shumë faktorë të veçantë të identitetit të tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose social.

“**Procesimi**” nënkupton çdo përpunim, veprim ose një numër veprimesh që kryhen në të dhënat personale: qoftë me mjete automatike apo jo automatike siç mund të jenë mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose përmirësimi, korrigjimi, konsultimi, shfrytëzimi, emetimi i transmetuar, përhapja ose mundësia e vendosjes, radhitja, kombinimi, bllokimi, fshirja ose asgjësimi i të dhënave.

“**Procesori**” nënkupton personin fizik ose juridik, autoritetin publik, agjencinë ose ndonjë tjetër entitet që i përpunon të dhënat personale në emër të kontrolluesit.

“**Tregtari**” nënkupton ndërmarrjen tregtare shpërndarëse ose shërbyese.

“**Të dhënat e dërguara**” nënkupton çdo të dhënë të procesuar me qëllim të transmetimit në rrjet të komunikimit elektronik ose për qëllim të lajmërimit.

“**Shfrytëzuesi**” nënkupton personin fizik që i shfrytëzon shërbimet publike elektronike të komunikimit në dispozicion, për qëllime private ose të biznesit- pa domosdoshmëri regjistrimi paraprak për këtë shërbim.

“**Shërbimi i vlerës së shtuar**” nënkupton çdo shërbim që kërkon procesim të të dhënave të dërguara ose të dhënat e vendndodhjes, që ndryshojnë vetëm nga të dhënat në dërgim tejet të nevojshme për normën e transmetimit ose të faturimit të një komunikimi.

Neni 3

Ndryshimi me marrëveshje

3.1. Për palët e përfshira në gjenerimin, dërgimin, pranimin, ruajtjen apo procesimin e mesazhit të dhënave, nëse nuk jepet ndryshe ,atëherë dispozitat e kapitullit III mund të ndryshojnë me marrëveshje.

3.2. Paragrafi (1) nuk ka ndikim në ndonjë të drejtë që mund të ekzistojë , të ndryshoj me marrëveshje ndonjë rregull të ligjit që jepet në kapitullin II.

Kapitulli II

Zbatimi i kërkesave ligjore për mesazhet e të dhënave

Neni 4

Njohja ligjore e mesazheve të të dhënave

Informacioni nuk duhet ta mohojë efektin ligjor, vlefshmërinë a zbatimin vetëm mbi bazat e asaj që është në formë të mesazhit të dhënave e as mbi bazat që nuk janë përfshirë në mesazhin e të dhënave me qëllim të lëshimit të një efekti të tillë ligjor, por i referohet vetëm atij mesazhi të dhënash.

Neni 5

Shkrimi

5.1. Kur ligji kërkon që informacioni të jetë në formë të shkruar, atëherë kërkesa e tillë plotësohet me një mesazh të dhënave, nëse përmbajtja në këtë informacion është e qasshme në mënyrë të tillë që të jetë e shfrytëzueshme për referencë të mëpastajshme.

5.2. Paragrafi (1) zbatohet nëse kërkesa është në formë të obligimit ose thjeshtë nëse ligji paraqet pasojat kur informacioni nuk është në formën e shkruar.

Neni 6 Nënshkrimi

6.1. Kur ligji obligon nënshkrimin e personit, atëherë kjo kërkesë plotësohet në lidhje me mesazhin e të dhënave nëse:

- (a) metoda shfrytëzohet për ta identifikuar atë person dhe për të treguar miratimin e personit për informacionin e përfshirë në mesazhin e të dhënave dhe
- (b) metoda është aq e besueshme dhe si e tillë është aq e përshtatshme për qëllimet për të cilat mesazhi i të dhënave është gjeneruar ose komunikuar ,duke marrë parasysh të gjitha rrethanat,duke përfshirë këtu çfarëdo marrëveshje relevante.

6.2. Paragrafi (1) zbatohet nëse kërkesa është në formë të një obligimi ose nëse ligji paraqet pasojat për mungesën e nënshkrimit.

Neni 7 Origjinali

7.1. Kur ligji kërkon që informacioni të paraqitet ose të mbahet në formën e vet origjinale, atëherë një kërkesë e tillë plotësohet nga mesazhi i të dhënave nëse:

- (a) ekziston një siguri e besueshme për integritetin e informatës nga koha kur për herë të parë është gjeneruar në formën e vet përfundimtare si mesazh i të dhënave apo ndryshe, dhe
- (b) kur kërkohet që informacioni të paraqitet, atëherë ky informacion duhet të jetë në gjendje t'i paraqitet personit të cilit duhet t'i prezantohet.

7.2. Paragrafi (1) zbatohet nëse kërkesa është në formë të obligimit ose nëse ligji paraqet pasoja për mosparaqitjen apo mos ruajtjen e mesazhit në formën origjinale.

7.3. Për qëllimet e nën paragrafit (a) të paragrafit (1) kriteret për vlerësimin e integritetit duhet të jenë:

- (a) nëse informacioni ka mbetur i kompletuar dhe pandryshuar, pavarësisht nga shtimi i ndonjë miratimi (marrëveshjeje) ose ndryshimi që rezulton në rrjedhën normale të komunikimit, të ruajtjes ose të paraqitjes dhe
- (b) standardi i kërkuar i sigurisë duhet të vlerësohet duke marrë parasysh qëllimin për të cilin informacioni është gjeneruar dhe të gjitha rrethanat e tjera relevante.

Neni 8 Pranimi dhe pesha e dëshmisë së mesazheve të të dhënave

8.1. Në çdo procedurë ligjore, gjatë zbatimit të rregullave për dëshmitë asgjë nuk do të zbatohet në atë mënyrë që t'ua mohojë pranimin e mesazhit të dhënave si dëshmi:

- (a) mbi bazë të asaj që është mesazh i të dhënave ose

- (b) nëse dëshmia më e mirë është se personi që e paraqet atë në mënyrë të arsyeshme mund të shpresojë ta përdorë mbi bazat se nuk është në formën e vet origjinale.

8.2. Informatës, në formën e mesazhit të të dhënave, duhet t'i jepet rëndësi përkatëse e dëshmisë. Në vlerësimin e peshës së dëshmisë të mesazhit të dhënave, kujdes duhet t'i kushtohet sigurisë së mënyrës në të cilën është gjeneruar mesazhi i të dhënave, ruajtur ose komunikuar, në sigurinë e mënyrës në të cilën është ruajtur tërësia e informacionit, për mënyrën në të cilën është identifikuar autori edhe çfarëdo faktori tjetër relevant.

Neni 9

Ruajtja e mesazheve të të dhënave

9.1. Kur ligji kërkon që mesazhet (dokumentet, regjistrimet apo informacionet) e caktuara të ruhen, atëherë një kërkesë e tillë përmbushet me kusht që:

- (a) përmbajtja e mesazheve të jetë e kuptueshme dhe e shfrytëzueshme për referenca të më vonshme,
- (b) mesazhi i të dhënave ruhet në formatin, në të cilin është gjeneruar, dërguar ose pranuar ose në formatin, në të cilin mund të demonstrohet për të paraqitur saktësinë e informacionit të gjeneruar, të dërguar apo të pranuar dhe
- (c) një informacion i tillë, ruhet si i tillë e që mundëson identifikimin e prejardhjes dhe destinimin e mesazhit të të dhënave si dhe datën dhe kohën kur është dërguar ose pranuar.

9.2. Obligimi për ruajtjen e dokumenteve, regjistrimeve ose të informacioneve në përputhje me paragrafin (1) nuk vlen për çfarëdo informacioni, qëllimi i vetëm i të cilit është të mundësojë pranimin ose dërgimin e mesazhit.

9.3. Personi mund të plotësojë kërkesën dhe i referohet paragrafit (1), duke shfrytëzuar shërbimet të cilido person tjetër, me kusht që të plotësohen kushtet e paraqitura në (a), (b) dhe (c) të paragrafit (1).

Kapitulli III

Komunikimi i mesazheve të dhënave

Neni 10

Formimi dhe validiteti i kontratave

Në lidhje me sajimin e kontratës, përveç kur palët merren vesh ndryshe, oferta dhe pranimi i ofertës mund të shprehen me mjetet e mesazheve të dhënave. Kur mesazhi i të dhënave shfrytëzohet për formimin e kontratës, atëherë asaj nuk duhet t'i mohohet validiteti ose zbatimi në bazë të asaj që mesazhi i të dhënave është shfrytëzuar për atë qëllim.

Neni 11

Njohja e mesazheve të të dhënave nga palët

Marrëveshja ndërmjet autorit dhe marrësit të të dhënave në formë deklarate të vullnetit të mirë ose ndonjë forme tjetër deklarative, nuk duhet t'i mohohet efekti ligjor, validiteti ose zbatimi që janë mbi bazat dhe në formën e mesazhit të të dhënave.

Neni 12
Atribuimi i mesazheve të të dhënave

- 12.1. Një mesazh i të dhënave është i autorit, nëse ai është dërguar nga autori i mesazhit.
- 12.2. Ndërmjet autorit dhe marrësit konsiderohet se mesazhi i të dhënave i takon autorit nëse është dërguar:
- (a) nga personi që ka pasur autoritet të veprave në emër të autorit në lidhje me mesazhin e të dhënave ose
 - (b) nga sistemi informativ i programuar nga, ose i cili vepron automatikisht në emër të autorit.
- 12.3. Ndërmjet autorit dhe marrësit, marrësit i jepet e drejta të vlerësojë mesazhin e të dhënave se i takon autorit dhe të veprave në atë supozim, nëse:
- (a) marrësi ka zbatuar, siç duhet procedurën me pëlqimin më parë të autorit për qëllim të sigurohet nëse mesazhi i të dhënave ka qenë nga autori
 - (b) mesazhi i të dhënave, si i pranuar nga marrësi, rezulton nga veprimet e personit, lidhshmëria e të cilit me autorin apo me ndonjë tjetër person- agjent i mundëson atij personi të ketë qasje në metodën e shfrytëzuar nga autori për të identifikuar mesazhin e të dhënave ashtu si të tij.
- 12.4. Paragrafi (3) nuk zbatohet:
- (a) Nga koha kur marrësi ka marrë njoftimin nga autori se mesazhi i të dhënave nuk është i autorit dhe ka pasur kohë të mjaftueshme për të vepruar në përputhje; ose
 - (b) Në rastin në kuadër të paragrafit (3)(b), në çdo kohë, kur marrësi ka qenë në dijeni ose është dashur të dijë, ka shfaqur kujdes të arsyeshëm apo ka shfrytëzuar ndonjë procedurë të pajtuar, që mesazhi i të dhënave nuk i takon autorit.
- 12.5. Marrësi ka të drejtë, të konsiderojë të pranuar mesazhin e të dhënave, ashtu siç autori ka synuar të dërgojë, dhe të veprave mbi atë supozim, nëse mesazhi i të dhënave është i autorit apo merret si i tij.
- 12.6. Marrësi nuk ka të drejtë sipas paragrafit 5, kur ka qenë apo është dashur të jetë në dijeni, se transmetimi i mesazhit të pranuar për të dhënave, ka rezultuar me gabime.
- 12.7. Marrësi ka të drejtë të konsiderojë secilin mesazh të dhënave, ta marrë si mesazh të veçantë të dhënave dhe të veprave mbi atë supozim, përveç në rastin kur i njëjti mesazh është përsëritur dhe marrësi ka qenë në dijeni apo është dashur ta dinte, i ka kushtuar kujdes të arsyeshëm ose e ka shfrytëzuar ndonjë procedurë të pajtuar, se mesazhi i të dhënave është i përsëritur.

Neni 13
Pranimi me konfirmim

- 13.1. Paragrafët (2) deri (4) të këtij neni zbatohet në kohën ose para dërgimit të mesazhit të të dhënave ose në kuptimin e atij mesazhi të të dhënave, autori ka kërkuar apo është pajtuar me marrësin që pranimi i mesazhit të të dhënave të jetë i konfirmuar.

13.2. Kur autori nuk pajtohet me marrësin që konfirmimi në pranim të jepet në një formë të veçantë ose me një metodë të veçantë, atëherë konfirmimi i pranimit mund të jepet me:

- (a) ndonjë komunikim me marrësin, automatikisht ose në çfarëdo forme tjetër, apo
- (b) ndonjë veprim i marrësit i mjaftueshëm për t'i treguar autorit se mesazhi i të dhënave është pranuar.

13.3. Kur autori i mesazhit i të dhënave ka shprehur se mesazhi i të dhënave kushtëzohet me konfirmim të marrjes, atëherë mesazhi i të dhënave, përderisa nuk pranohet konfirmimi, trajtohet sikur të mos ishte dërguar.

13.4. Kur autori i mesazhit nuk ka deklaruar se mesazhi i të dhënave kushtëzohet me pranimin e konfirmuar të marrjes dhe ky konfirmim nuk është pranuar nga autori brenda kohës së specifikuar ose janë marrë vesh, apo nuk është specifikuar a pajtuar për kohën, ose brenda kohës së arsyeshme, atëherë autori:

- (a) mund ta njoftojë marrësin dhe i thotë se ai nuk ka marrë ndonjë konfirmim dhe specifikimin e kohës së arsyeshme, deri kur duhet të pranohet konfirmimi për pranimin e mesazhit të të dhënave; dhe
- (b) nëse pranimi nuk konfirmohet brenda kohës së specifikuar në nën paragrafin (a) në njoftim për marrësin mund ta trajtojë mesazhin e të dhënave sikur nuk është dërguar asnjëherë ose të ushtrojë ndonjë të drejtë që mund ta ketë.

13.5. Kur autori i mesazhit ta ketë marrë konfirmimin për pranimin e mesazhit nga marrësit, atëherë merret se mesazhi i të dhënave është pranuar nga ana e marrësit. Ky supozim nuk nënkupton se mesazhi i të dhënave korrespondon me mesazhin e pranuar.

13.6. Kur pranimi i konfirmimit tregon se mesazhi i të dhënave i plotësonte kërkesat teknike, qoftë të pajtuara ose të paraqitura në standardet aplikuese, supozohet se kërkesat janë plotësuar.

13.7. Përveç që ka të bëjë me dërgimin ose me pranimin e mesazhit të të dhënave, ky nen nuk ka për qëllim të merret me pasojat ligjore që mund të dalin qoftë nga ai mesazh i të dhënave apo nga pranimi i konfirmimit të tij.

Neni 14

Koha dhe vendi i dërgimit dhe i pranimit të mesazheve të të dhënave

14.1. Përveç nëse merren vesh ndryshe, autori dhe marrësi, dërgimi i mesazhit më të dhënat ndodh pasi të futet në sistemin e informatave, jashtë kontrollit të autorit, ose të personit i cili ka dërguar atë mesazh të të dhënave në emër të autorit.

14.2. Përveç nëse merren vesh ndryshe, autori dhe marrësi, koha e pranimit të mesazhit të të dhënave përcaktohet si vijon:

- (a) nëse marrësi ka caktuar sistemin e informatave për qëllimin e pranimit të mesazheve të të dhënave bëhet:
 - (i) në kohën kur mesazhi i të dhënave futet në sistemin e caktuar informatik; ose
 - (ii) nëse mesazhi i të dhënave është dërguar në sistemin informatik të marrësit që nuk është sistem i caktuar informatik në kohën kur mesazhi i të dhënave është korrigjuar nga marrësi;

- (b) nëse marrësi nuk e ka caktuar sistemin informatik, pranimi bëhet kur mesazhi i të dhënave futet në sistemin informatik të marrësit.

14.3. Paragrafi (2) zbatohet pavarësisht nga vendi ku sistemi informatik është vendosur, mund të jetë i ndryshëm nga vendi ku mesazhi i të dhënave konsiderohet të jetë pranuar sipas paragrafit (4).

14.4. Përveç nëse merren vesh ndryshe, autori dhe marrësi, mesazhi i të dhënave konsiderohet se është dërguar në vendin ku marrësi e ka vendosur biznesin. Për qëllimet e këtij paragrafi vlen:

- (a) nëse autori ose marrësi ka më shumë se një vend në të cilin e zhvillon biznesin, vendi i biznesit është ai që ka afërsi më të madhe me transaksionin e dhënë, kur nuk ekziston transaksioni i dhënë që është vendi kryesor i biznesit;
- (b) nëse autori ose marrësi, nuk kanë vend të biznesit, referimi duhet të bëhet në vendbanimin e tyre.

PJESA E DYTË- TREGTIA ELEKTRONIKE NË FUSHA SPECIFIKE

Kapitulli IV

Transporti i mallrave

Neni 15

Veprimet në lidhje me kontratat për transportin e mallrave

Pa përjashtuar dispozitat e pjesës së parë të këtij ligji, ky kapitull zbatohet për çfarëdo veprimi në lidhje me ose në zbatim të kontratës së transportit të mallrave, duke përfshirë, por jo kufizuar, në:

- a) ofrimin e shenjave, të, numrit, sasisë ose të masës së mallrave;
- b) paraqitjen e natyrës dhe të vlerës së mallrave;
- c) lëshimin e faturës së mallrave;
- d) konfirmimin se mallrat janë ngarkuar;
- e) njoftimin e personit për afatet dhe për kushtet e kontratës;
- f) dhënien e udhëzimeve për transportuesin;
- g) kërkesën për furnizim të mallrave;
- h) autorizimin e lëshuar për mallrat;
- i) njoftimin për humbje ose dëmtim të mallrave;
- j) dhënien e çfarëdo njoftimi tjetër ose deklarate në lidhje me kryerjen e kontratës;
- k) aktivitetin për t'u furnizuar me mallra te personi i emëruar ose te personi i autorizuar për të kërkuar furnizim;
- l) dhënien, sigurimin, refuzimin, nënshtrimin, transferimin ose negociimin e të drejtave për mallra;
- m) sigurimin ose transferimin e të drejtave dhe të obligimeve sipas kontratës.

Neni 16 Dokumentacioni i transportit

16.1. Varësisht nga paragrafi (3), kur ligji kërkon që ndonjë veprim që i referohet nenit 15 të kryhet në formë të shkruar ose duke shfrytëzuar dokument letre që të plotësohet kërkesa nëse veprimi është kryer duke shfrytëzuar një ose më shumë mesazhe të të dhënave.

16.2. Paragrafi (1) zbatohet, kur kërkesa është obligim ose kur ligji thjeshtë paraqet pasojat e mos përmbushjes së kërkesave në të shkruar, si dokument në formë të letrës.

16.3. Nëse duhet të autorizohet ndokush, ose duhet të kryhet ndonjë obligim vetëm nga një person dhe nëse ligji këtë e kërkon në mënyrë që ta adresojë këtë çështje, të drejtat dhe obligimet duhet të barten tek ai person me transferimin ose me shfrytëzimin e dokumentit në format të letrës. Kjo kërkesë konsiderohet se është përmbushur nëse e drejta është bartur duke shfrytëzuar një apo më shumë mesazhe të të dhënave duke vërtetua se është zbatuar metoda e besueshmërisë për paraqitje të mesazheve të tilla të të dhënave o të mesazheve unike.

16.4. Për qëllimet e paragrafit (3), standardi i kërkuar i besueshmërisë duhet të vlerësohet në qartësimin e qëllimit për të cilin e drejta ose obligimi është bartur dhe në qartësimin e të gjitha rrethanave, duke përfshirë edhe marrëveshjen relevante.

16.5. Kur shfrytëzohen një ose më shumë mesazhe të dhënave, për të arritur efektin në ndonjë veprim në nën paragrafët (f) dhe (g) të nenit 15 asnjë dokument në formë letre i shfrytëzuar për të pasur efekt në një veprim të tillë, nuk është valid përderisa shfrytëzimi i mesazheve të të dhënave është përfunduar ose zëvendësuar me shfrytëzimin e dokumenteve në formë letre. Dokumenti nga letra i shfrytëzuar në këto rrethana duhet të përmbajë deklaratën për një përfundim të tillë. Zëvendësimi i mesazheve të të dhënave nga dokumentet në formë letre, nuk do të kenë efekt në të drejtat as obligimet e palëve të përfshira.

16.6. Nëse një rregull e ligjit është detyrimisht e zbatueshme, për të kontraktuar transportin e mallrave, që është evidencuar nga dokumenti në formë letre, atëherë një rregull e tillë duhet të jetë e zbatueshme për atë kontratë të transportit të mallrave që është evidencuar nga një apo më shumë mesazhe të të dhënave, për arsye se kontrata është evidentuar nga një ose më shumë mesazhe të të dhënave në vend të dokumentit në formë të letrës.

PJESA III – SHËRBIMET E SHOQËRISË INFORMATIKE Kapitulli V

Themelimi dhe kërkesat informatike

Neni 17 Themelimi dhe autorizimi

17.1. Ofrimi i shërbimeve të shoqërisë informatike nuk duhet të kërkojë autorizim paraprak ose çfarëdo kërkesë tjetër që ka efekt ekuivalent, me përjashtim të:

- a) ofruesit e shërbimeve që shfrytëzojnë infrastrukturën e tyre duhet të marrin autorizime sipas ligjit në zbatim për telekomunikacion (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/16);
- b) ofruesit e shërbimeve financiare ose të sigurimit, sipas ligjeve për ato shërbime.

17.2. Shërbimet e shoqërisë informatike janë cilado shërbime që normalisht janë ofruara për pagesë në largësi me anë të mjeteve elektronike dhe me kërkesa individuale të shfrytëzuesit të shërbimit.

17.3. Për qëllim të këtij definimi në paragrafët e mëparshëm (1):

- a) “në distancë” nënkuptohet që shërbimi ofrohet pa praninë fizike të palëve në të njëjtën kohë;
- b) “ me mjete elektronike” do të thotë se shërbimi fillimisht është dërguar dhe pranuar në destinimin e tij me anë të pajisjeve elektronike për procesim- duke përfshirë kompresimin digjital dhe ruajtjen e të dhënave të transmetuara në tërësi, të bartura dhe të pranuar me tela, (telefon) me radio, me anë të mjeteve optike ose me mjete të tjera elektromagnetike;
- c) “nga kërkimet individuale të një marrësi të shërbimeve”: do të thotë se shërbimi është ofruar me anë të transmetimit të të dhënave sipas kërkesës individuale.

17.4. Ky ligj nuk do të zbatohet për:

- a) shërbimet që nuk ofrohen” në distancë”;
- b) shërbimet e ofruara në praninë fizike të ofertuesit dhe të marrësit, edhe në qoftë se ato përfshijnë përdorimin e pajisjeve elektronike:
 - i) ekzaminimet mjekësore ose tretmanët në ambulanca mjekësore, duke përdorur mjetet elektronike, ku pacienti është fizikisht i pranishëm
 - ii) konsultimet e një katalogu elektronik në një shitore në prani të klientit; rezervimi i biletave të aeroplanit në agjencitë turistike në praninë fizike të klientit, me anë të mjeteve të rrjetit të kompjuterit;
 - iii) lojërat elektronike të qasshme video-arcade ku klienti vetëm fizikisht është i pranishëm
- c) për shërbimet që nuk ofrohen; me anë të mjeteve elektronike;
- d) shërbimet që kanë përmbajtje materiale, edhe pse ofrohen nëpërmjet pajisjeve elektronike:
 - i) arkat automatike ose aparatet për furnizim me bileta (bankënota, bileta treni);
 - ii) qasje në rrjetin rrugor, parkingjet etj, obligimet për shfrytëzim edhe nëse janë mjete elektronike në hyrje-dalje, të qasjes kontrolluese dhe/ose duke siguruar së pagesa ishte korrekte.
- e) shërbimet e shkyçura, shpërndarja e CDROM-it ose e softuerëve në disketa;
- f) shërbimet që nuk janë ofruar nëpërmjet procesimit elektronik, ose sistemit të tillë, duke përfshirë, por jo të limituar për:
 - i) shërbimet telefonike me zë;
 - ii) telefaksit/telex dhe shërbimet e teleksit;
 - iii) shërbimet e ofruara nëpërmjet telefonisë me zë apo faks;
 - iv) konsultimi me doktorin me telefoni-faks;
 - v) konsultimit me avokatin me telefon-faks
 - vi) marketingu i drejtpërdrejtë telefon-telefaks.

- g) Për shërbimet që nuk kompletohen "me kërkesën individuale të marrësit të shërbimeve";
- h) Shërbimet e ofruara me transmetimin e të dhënave pa kërkesën individuale për pranimin në të njëjtën kohë nga një numër i pakufizuar i marrësit individual (për një pikë deri te shumë pika të transmetuara):
 - i) shërbimet e radiotransmetimit;
 - ii) shërbimet e televizionit transmetues;
 - iii) teleteksti i siguruar nga televizioni;
 - iv) të gjitha shërbimet e transmetimit të definuara nga Ligji i telekomunikacionit (Rregullorja e UNMIK 2003/16).

Neni 18

Informacioni i përgjithshëm që duhet ta ofrojë ofruesi i shërbimit

18.1. Ofruesi i shërbimit duhet të ofrojë qasje të përhershme të lehtë dhe direkte për pranuesit e shërbimit dhe për autoritetet kompetente të paktën për informacionet në vijim:

- a) emrin e ofruesit të shërbimit;
- b) adresën e vendit- në të cilën është vendosur ofruesi i shërbimit;
- c) adresën e emailit dhe lokatorin universal regjistruar (URL) të ofruesit të shërbimit;
- d) regjistrimin e biznesit, në të cilin ofruesi i shërbimit ka hyrë dhe numrin e tij të regjistrimit (nëse ekziston një i tillë);
- e) hollësitë e autoritetit relevant mbikëqyrës (ku aktiviteti është subjekt i një skeme autorizuese);
- f) për profesionet e lidhura me tregtinë elektronike:
 - (i) çfarëdo entiteti profesional ose institucion i ngjashëm me të cilin ofruesi i shërbimit është i regjistruar;
 - (ii) titulli profesional dhe juridiksioni ku është dhënë;
 - (iii) referencë për rregullat profesionale të zbatueshme në juridiksionin e ndërmarrjes dhe mjetet për të pasur qasje në to;
- g) TVSH – numri identifikues i tatimit (nëse zbatohet).

18.2. Kur shërbimet e shoqërisë informatike u referohen çmimeve, duhet të shënohen qartë, por shënohen edhe nëse i kanë përfshirë tatimin dhe kostot e shpërndarjes.

Kapitulli VI

Komunikimet komerciale

Neni 19

Informacioni që duhet të ofrohet

Komunikimet komerciale që janë pjesë e shërbimit të shoqërisë informatike, duhet të përputhen të paktën me kushtet e dhëna në vazhdim:

- a) komunikimet komerciale si të tilla duhet të identifikohen qartë;

- b) personi fizik ose juridik në emër të cilit është bërë komunikimi komercial duhet të identifikohet qartë;
- c) ofertat reklamuese si zbritjet e çmimeve, premitë dhe dhuratat, si të tilla duhet të identifikohen qartë, duke përfshirë kushtet që duhet të plotësohen që ato të kualifikohen;
- d) konkurrenca reklamuese ose lojërat e lejuara sipas ligjit, aty ku është themeluar ofruesi i shërbimit, duhet të jenë të identifikueshme qartë duke përfshirë edhe kushtet tjera për pjesëmarrje.

Neni 20

Komunikimet e padëshiruara komerciale

20.1. Komunikimet e padëshirueshme komerciale të postes elektronike janë të lejuara me kusht që, komunikimet e tilla nga ofruesi i shërbimit të identifikohen qartë si të tilla.

20.2. Ofruesit e shërbimeve rregullisht duhet të konsultojnë dhe t'i respektojnë regjistrat në të cilët personat fizik që nuk dëshirojnë të marrin komunikime të tilla komerciale, mund ta regjistrojnë veten e tyre.

Neni 21

Profesionet të lidhura me tregtinë elektronike

21.1. Shfrytëzimi i komunikimeve komerciale që janë pjesë e një shërbimi të shoqërisë informatike të ofruara nga profesionistët e lidhur me tregtinë elektronike, lejohet, varësisht nga rregullat e profesionit lidhur me pavarësinë, dinjitetin dhe nderin profesional, fshehtësinë profesionale dhe korrektësinë ndaj klientëve ose anëtarëve të tjerë të profesionit.

21.2. Entitetet profesionale dhe shoqatat nxiten të krijojnë kode të sjelljes që duhet të jenë plotësisht në përputhje me standardet evropiane dhe me ato ndërkombëtare

Kapitulli VII

Kontratat e bëra në mënyrë elektronike

Neni 22

Informacioni që duhet të ofrohet

22.1. Kontratë elektronike nënkupton një kontratë të lidhur pjesërisht apo plotësisht në formën e komunikimeve elektronike, pjesërisht ose plotësisht në formë elektronike.

22.2. Informacioni në vazhdim duhet të jepet nga ofruesi i shërbimit para se të bëhet porosia nga pranuesi i shërbimit, përveç nëse merren vesh ndryshe nga palët që nuk janë konsumatorë:

- a) hapat e ndryshëm teknik për ta pasuar përmbushjen e kontratës;
- b) kontrata, qoftë e përmbushur apo jo, duhet të arkivohet nga ofruesi i shërbimit, ashtu që të ketë qasje në të;

- c) mjetet teknike për të identifikuar dhe për t'i përmirësuar gabimet e futura para se të bëhet porosia;
- d) gjuhët e ofruara për lidhjen e kontratës.

22.3. Përveç kur palët që nuk janë konsumatorë arrijnë marrëveshje tjetër, ofruesi i shërbimit tregon kodin e sjelljes, në të cilat ai përshkruan dhe tregon se si mund të paraqiten këto kode në formën elektronike.

22.4. Dispozitat e paragrafëve (2) dhe (3) nuk zbatohen për kontratat e arritura ekskluzivisht nga shkëmbimi i postës elektronike ose i komunikimeve individuale.

22.5. Afatet e kontratës dhe kushtet e përgjithshme për pranuesin duhet të vihen në dispozicion në atë mënyrë që t'i lejohet atij t'i ruaj dhe t'i riprodhojë ato.

Neni 23 Vendosja e porosisë

23.1. Përveç në rastet kur palët që nuk janë konsumatorë merren vesh ndryshe, atëherë ofruesi i shërbimit që merr porosinë me anë të mjeteve teknologjike, duhet të vërtetojë pranimin e porosisë së pranuesit pa një vonesë të duhur dhe me mjete elektronike. Porosia dhe konfirmimi konsiderohet se janë pranuar kur palët të cilave u adresohen janë në gjendje të kenë qasje në to.

23.2. Përveç në rastet kur palët që nuk janë konsumatorë merren vesh ndryshe, ofruesi i shërbimit vë në dispozicion të pranuesit të shërbimit të duhur me mjetet efektive dhe teknike që i lejojnë atij t'i identifikojë dhe përmirësojë gabimet e futura para se të bëhet porosia.

23.3. Dispozitat në paragrafët (1) dhe (2) nuk zbatohen për kontratat e arritura ekskluzivisht nga shkëmbimi i postës elektronike apo me komunikime ekuivalente individuale.

Kapitulli VIII Besueshmëria e ofertuesve ndërmjetësues të shërbimit

Neni 24 Kanali komunikues

Kur ofruesi i shërbimit të shoqërisë informatike ofron shërbimin që përbëhet nga transmetimi në rrjetin e komunikimit të informatave nga marrësi i shërbimit ose nga ofrimi i qasjes në rrjetin e komunikimit atëherë ofruesi i shërbimit nuk është përgjegjës për informacionin e transmetuar, po qe se ai:

- a) nuk e inicion transmetimin;
- b) nuk e zgjedhë pranuesin e transmetimit;
- c) nuk e zgjedh ose modifikon informacionin e përfshirë në transmetim (bartje).

Neni 25 Mbajtja

Kur ofruesi i shërbimit të shoqërisë informatike ofron shërbim që përbëhet nga transmetimi në rrjetin komunikues të informatave, nga marrësi i shërbimit porse ofruesi i shërbimit nuk është përgjegjës për ruajtje automatike të ndërmjetësojë dhe përkohësisht ta ruajë atë informatë të kryer vetëm për qëllim që informata të bëhet më efikase për tu transmetuar te pranuesit e tjerë të shërbimit me kërkesë të tyre, po qese ai:

- a) nuk e modifikon informacionin;
- b) përputhet me kushtet për qasje informacionit;
- c) përputhet me rregullat lidhur me freskimin e informacionit të specifikuar në mënyrën e njohur gjerësisht dhe të shfrytëzuar në industri;
- d) nuk ndërhyt me shfrytëzimin ligjor të teknologjisë së njohur gjerësisht dhe të shfrytëzuar në industri për të marrë të dhëna për shfrytëzimin e informacionit;
- e) vepron shpejt për të larguar apo pamundësuar qasjen në informacion në burimin fillestar të transmetimit që është larguar nga rrjeti ose qasja në të është pamundësuar apo që gjyqi ose autoriteti administrativ ka urdhëruar largimin ose pamundësimin e tillë.

Neni 26 Nikoqirllëku

Nëse ofruesi i shërbimit të shoqërisë informatike ofron ruajtjen e informacionit të ofruar nga marrësi i shërbimit, ai nuk është përgjegjës për informacionin e ruajtur në kërkesë të pranuesit të shërbimit po qe se ai:

- a) nuk ka njohuri për aktivitet ilegal ose për informacionin ilegal dhe sa i përket kërkesës për dëmtimet nuk është në dijeni të fakteve të rrethanave nga të cilat rrjedhin aktivitetet dhe informacionet ilegale; apo
- b) në marrjen e dijenisë ose të njohurisë së tillë, vepron menjëherë për ta larguar ose pamundësuar qasjen në informacion.

Neni 27 Nuk ka obligime të përgjithshme për të monitoruar

Ofruesit e shërbimeve të shoqërive informatike kur të ofrojnë shërbimet që përfshihen në nenet e këtij kapitull - kanali komunikues, mbajtja dhe nikoqirllëku, nuk kanë obligime të veçanta për të monitoruar informacionin që ato e transmetojnë ose e ruajnë e as obligime të përgjithshme që aktivisht të kërkojnë fakte ose rrethana ku tregohet aktiviteti ilegal.

PJESA IV – KONTRATAT NË DISTANCË
Kapitulli IX

Definicioni dhe fushëveprimi

Neni 28

Definicioni dhe fushëveprimi

28.1. Kontrata në distancë paraqet kontratën në lidhje me mallra ose me shërbime të lidhura ndërmjet furnizuesit dhe konsumatorit sipas, një distance të organizuar të shitjes ose skemës së ofrimit të shërbimit që udhëhiqet nga furnizuesi i cili shfrytëzon mjetet e komunikimit në distancë, deri në momentin që lidhet kontrata.

28.2. Komunikimi në distancë përfshin çfarëdo mjeti që përdoret për të lidhur kontratë pa praninë fizike të furnizuesit dhe të konsumatorit. Shembujt e tillë mund të jenë, por nuk kufizohen për:

- a) përmbajtjet e shtypura , pa adresuar;
- b) përmbajtjet e shtypura të adresuara;
- c) letrat standarde;
- d) reklamimin në shtyp në formë porosie;
- e) katalogun;
- f) telefonatat me intervenimin e njeriut;
- g) telefonimin pa intervenim të njeriut (makina e thirrjes automatike ose audioteksti);
- h) radioja;
- i) videofoni (telefoni me ekran);
- j) videoteksti (mikrokompjuteri dhe ekrani televiziv) me tastaturë ose me ekran që preket;
- k) posta elektronike;
- l) makina faksimil (faksi);
- m) televizioni (teleshopi).

Neni 29

Përjashtimet

29.1. Ky ligj nuk zbatohet për kontratat:

- a) e lidhura për shërbimet financiare ose të sigurimit për të cilat aplikohet marketingu në distance i shërbimeve financiare të konsumatorit;
- b) e lidhura me mjete automatike të shitjes ose vendet automatike tregtare;
- c) e lidhura me ofruesit e shërbimit të telekomunikimit me anë të shfrytëzimit të telefonave publikë;
- d) e lidhura për ndërtimin dhe shitjen e pasurisë së patundshme ose lidhur me të drejtat e tjera të pasurisë së patundshme përveç atyre të qirasë;
- e) e lidhura në ankand.

29.2. Kërkesat që kanë të bëjnë me nenin 30, 31, 32 dhe neni 33 nuk aplikohen për:

- a) kontratat për furnizim me gjëra ushqimore, pije ose mallra të tjera të konsumit të përditshëm që furnizohen në shtëpi të konsumatorit, në vendbanimin e tij ose në vendin e tij të punës nga furnizuesit e rregullt të përditshëm;

- b) Kontratat për ofrimin e akomodimit, transportit, furnizimit me ushqime apo shërbime ndërmjetësuese që i ndërmerr furnizuesi në pajtim me kontratën, me përjashtim të veprimit të rrethanave të jashtëzakonshme, kur furnizuesi lirohet nga obligimi ndaj konsumatorit për t'i kthyer shumën e paguar.

Kapitulli X Procesi dhe procedurat

Neni 30 Informacioni paraprak

30.1. Brenda një kohe të arsyeshme para se të lidhet kontrata në distance, konsumatorit duhet t'i ofrohen informacionet si vijon:

- a) identitetin e furnizuesit dhe në rast se në kontratat kërkojnë pagesë në avans edhe adresën e tij;
- b) karakteristikat kryesore të mallrave dhe të shërbimeve;
- c) çmimin e mallrave dhe të shërbimeve ,duke përfshirë edhe tatimin;
- d) koston e transportit, kur kjo zbatohet;
- e) aranzhimet për pagesë, transport ose kryerje;
- f) e drejta për tërheqje;
- g) koston e shfrytëzimit të mjeteve të komunikimit në distancë, kur llogaritja bëhet ndryshe nga çmimi bazë;
- h) kohën, brenda së cilës oferta ose çmimi mbetet valid;
- i) kur ekzistojnë kushtet, minimumi i kohëzgjatjes së kontratës në rastin e kontratave për furnizim me produkte ose për shërbimeve që duhet të kryhen përherë apo në formë të përsëritur.

30.2. Gjithë informacioni i përmendur më sipër, që ka të bëjë me transaksionet komerciale, duhet të ofrohet në mënyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse. Kujdes i duhur duhet t'u kushtohet parimeve të besimit të mirë në transaksionet komerciale dhe parimet që rregullojnë mbrojtjen e të paafteve, minoritetet, në bazë të ligjit në zbatim.

30.3. Në rastin e komunikimeve telefonike duhet të bëhet veçanërisht të qarta identiteti i furnizuesit dhe qëllimi komercial i thirrjes dhe kjo duhet të jetë në fillim të të gjitha bisedave me konsumatorët.

Neni 31 Konfirmimi me shkrim i informacionit

31.1. Konsumatori duhet të marrë konfirmim me shkrim ose me ndonjë medium tjetër të qëndrueshëm dhe i qasshëm për të, për informatën e përmendur në nenin 30. Ky informacion duhet të ofrohet në një kohe të arsyeshme para përmbushjes së kontratës dhe më së voni në kohën e ofrimit të mallit, përveç nëse konsumatorit i është thënë para lidhjes së kontratës në formë të shkruar ose me medime të tjera të qëndrueshme.

31.2. Në rastet e tjera, këto informata duhet të përmbajnë:

- a) informacion të shkruar për kushtet dhe procedurat e ushtrimit të së drejtës për t'u tërhequr;
- b) adresën fizike të vendit të biznesit të furnizuesit të cilit konsumatori mund t'ia adresoj ndonjë ankesë;

- c) informacionin për shërbimet pas shitjes dhe garancitë që ekzistojnë;
- d) vendimin për anulimin e kontratës, aty ku kohëzgjatja është e paspecifikuar ose kohëzgjatja kalon një (1) vit.

31.3. Këto informata nuk janë të nevojshme për shërbimet që janë kryer me anë të përdorimit të mjeteve të komunikimit në distance, ku furnizimi është bërë vetëm në një rast dhe që janë faturuar nga ofruesi i shërbimit me anë të mjeteve të komunikimit në largësi. Konsumatori në të gjitha rastet duhet të jetë në gjendje ta marrë adresën e vendit të biznesit të furnizuesit të cilit mund t'ia adresojë çfarëdo ankese.

Neni 32

E drejta për t'u tërhequr

32.1. Për kontratën në distancë, konsumatori duhet të ketë kohën prej të paktën shtatë ditë pune brenda së cilës ai mund të tërhiqet nga kontrata.

32.2. Obligimi i vetëm për konsumatorin, për shkak të ushtrimit të së drejtës së tërheqjes është kostoja e drejtpërdrejtë e kthimit të mallit.

32.3. Koha për ushtrimin e kësaj së drejte fillon:

- a) në rastin e mallrave, nga dita e pranimit nga konsumatori ku obligimi lidhur me konfirmimin me shkrim të informacionit është plotësuar;
- b) në rastin e shërbimeve, nga dita e lidhjes së kontratës apo nga dita në të cilën obligimet lidhur me konfirmimin me shkrim të informacionit janë plotësuar nëse ato janë plotësuar pas lidhjes së kontratës, me kusht që kjo kohë të mos kalojë tre (3) muaj referuar në të ardhmen.

32.4. Nëse furnizuesi ka dështuar të plotësojë obligimet lidhur me konfirmimin me shkrim të informacionit, koha e plotësimit të atyre obligimeve do të jetë tre (3) muaj. Kjo kohë duhet të fillojë:

- a) në rastin e mallrave, nga dita e pranimit nga konsumatori;
- b) në rastin e shërbimeve, nga dita e lidhjes së kontratës.

32.5. Nëse detyrimi i konfirmimit të shkruar të informacionit është plotësuar brenda tre (3) muajsh, koha prej shtatë (7) ditësh, e përmendur më lartë, do të fillojë nga ai moment.

32.6. Nëse konsumatori ka ushtruar të drejtën e tij për t'u tërhequr, furnizuesi duhet të jetë i obliguar t'i kompensojë shumat e paguara nga konsumatori, kurse konsumatori nuk ka nevojë të paguajë diçka për këtë. Të vetmen pagesë që duhet ta bëjë konsumatori është kostoja e shkaktuar për kthimin e mallit. Një kompensim i tillë duhet të kryhet jo më shumë se 30 ditë.

32.7. Përveç në rastin kur palët merren vesh ndryshe, konsumatori nuk mund të ushtrojë të drejtën e vet për t'u tërhequr në lidhje me kontratat:

- a) për ofrimin e shërbimit nëse kryerja e shërbimit ka filluar me marrëveshje me konsumatorin para se të kenë kaluar shtatë (7) ditë pune të përmendura më lartë;
- b) për furnizim në mallra të bëra për specifikimet e konsumatorit ose për ato që qartë janë personalizuar ose për shkak të natyrës a përbërjes së tyre prishjen shpejtë ose ka detyrim të prishjes, ose afati u kalon shpejtë;

- c) për ofrimin e regjistrimit të zërit ose të atyre video, a të programeve të kompjuterëve që janë hapur nga konsumatori;
- d) për furnizim të gazetave të përditshme, periodike dhe të revistave;
- e) për lojërat dhe shërbimet e lotarisë.

32.8. Nëse çmimi i mallrave ose i shërbimeve plotësisht ose pjesërisht është i mbuluar me kredi të dhënë nga furnizuesi, ose nëse çmimi është plotësisht a pjesërisht i mbuluar me kredi të dhënë për konsumatorin nga një palë e tretë sipas marrëveshjes ndërmjet palës së tretë dhe furnizuesit, marrëveshja e kredisë duhet të anulohet pa ndonjë dënim nëse konsumatori e ushtron të drejtën e tij për t'u tërhequr nga kontrata.

Neni 33 Kryerja

33.1. Përveç në rastet kur palët merren vesh ndryshe, furnizuesi duhet ta kryejë porosinë brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita në vazhdim në të cilën konsumatori ka paraqitur porosinë tek furnizuesi.

33.2. Kur furnizuesi dështon ta kryejë pjesën e vet të kontratës për bazat në të cilat mallrat ose shërbimet e porositura nuk janë në dispozicion, konsumatori duhet të informohet për këtë situatë dhe duhet të jetë në pozitë të kompensohet sa më parë të jetë e mundur dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë.

33.3. Furnizuesi mund t'i ofrojë konsumatorit mallra ose shërbimet të cilësisë së lartë por me çmim të njëjtë, me kusht që kjo mundësi të jetë ofruar para lidhjes së kontratës ose pasi të lidhet ajo. Kostoja e kthimit të mallit në pasim të ushtrimit të së drejtës për t'u tërhequr në çdo rast duhet të mbulohet nga furnizuesi. Kurse konsumatori duhet të informohet për këtë gjë. Në raste të tilla furnizimi i mallrave nuk mund të merret se përbën shitje inerciale bazuar në nenin 35.

Neni 34 Pagesa me kartelë

Konsumatori ka të drejtë:

- a) të kërkojë anulimin e pagesës në rast mashtrim në kartelën e pagesës së tij me kartelë në lidhje me kontratat në distancë sipas këtij ligji;
- b) në rast mashtrim, t'i rikompensohet shuma e paguar ose t'i kthehet pagesa.

Neni 35 Shitje pa porosi

Ofruesit e shërbimit të shoqërisë informatike duhet të:

- a) ndalojë konsumatori pa i pas porositur konsumatori paraprakisht, në rastin kur një furnizim i tillë kërkon pagesën;
- b) përjashtoj konsumatorin nga çdo përgjegjësi në rastet e furnizimit të padëshiruar. Mungesa e përgjigjes nuk nënkupton pëlqim.

Neni 36

Kufizimet në shfrytëzimin e disa mjeteve për komunikimet në distancë

36.1. Shfrytëzimi nga furnizuesit e mjeteve në vazhdim kërkon pëlqim paraprak të konsumatorit:

- a) sistemi automatik i thirrjeve pa ndërhyrje të dorës së njeriut - aparate automatike të thirrjeve;
- b) aparate faksimil - faks.

36.2. Mjete të tjera të komunikimit në distancë, që mundësojnë komunikim individual, mund të shfrytëzohen vetëm nëse nuk ka vërejtje të qartë nga konsumatori.

Neni 37

Korrigjimi juridik ose administrativ

Për të siguruar se ky ligj është në zbatim si duhet, mund të ndërmerren veprime sipas ligjit në fuqi pranë gjykatave ose organeve administrative kompetente siç janë:

- a) organet publike ose përfaqësuesit e tyre;
- b) organizatat konsumuese;
- c) organizatat profesionale.

Neni 38

Natyra obliguese

Konsumatori nuk mund të heqë dorë nga të drejtat që i jepen atij me këtë ligj. Konsumatori nuk humb mbrojtjen që i është dhënë sipas ligjit të zgjedhur nga juridiksioni i jashtëm si ligj i zbatueshëm në kontratë, nëse më vonë do të ketë lidhshmëri të ngushtë me Kosovën ose me shtetet anëtare të Bashkësisë Evropiane.

PJESA E PESTË – FATURAT NË FORMËN ELEKTRONIKE

Neni 39

Detajet e kërkuara për faturat

39.1. Për faturim në tregtinë elektronike kërkohet:

- a) data e lëshimit;
- b) numri vijues, i bazuar në një ose më shumë numra vijues që identifikojnë faturat;
- c) numri identifikues i TVSH-së, sipas të cilit obliguesi tatimor furnizon me mallra ose shërbime
- d) emrin e plotë dhe adresën e obliguesit tatimor dhe të konsumatorit të tij;
- e) sasinë, çmimin për njësi dhe natyrën e mallrave të furnizimit ose shtrirjen e tyre dhe natyrën e shërbimeve të ofruara;
- f) datën në të cilën është bërë ose është kryer furnizimi me mallra ose me shërbime, ose datën në të cilën është bërë pagesa në xhirologari, ashtu që data të mund të përcaktohet dhe dallohet nga data e lëshimit të faturës;
- g) tatim për vlerë ose përjashtim, njësia e çmimit që përjashtohet nga tatimi dhe ndonjë zbritje çmimi ose kompensimi nëse ato nuk janë përfshirë në njësinë e çmimit;
- h) shkallën e TVSH-së së zbatuar;
- i) shumën e TVSH-së që duhet të paguhet.

39.2. Nuk kërkohet që fatura të nënshkruhet.

39.3. Shuma e paraqitet në faturë mund të shprehet në çfarëdo valute, me kusht që shuma e tatimit që duhet të paguhet, të shprehur në euro.

Neni 40

Faturat në letër ose me anë të mjeteve elektronike

40.1. Faturat mund të dërgohen qoftë në formë të letrës ose nëse konsumatori pranon, mund të dërgohen edhe në formën elektronike. Faturat e dërguara me anë të mjeteve elektronike, duhet të jenë të pranueshme në Kosovë, me kusht që të garantohen vërtetësia e prejardhjes dhe integriteti i përmbajtjes:

- a) me mjetet e nënshkrimit të avancuar elektronik sipas kuptimit të nenit 2 të Direktivës së EU-së 1999/93/EC dhe
- b) me mjetet e nënshkrimit elektronik të avancuar që duhet të bazohet në një vërtetim të kualifikuar dhe të krijuar nga pajisja e sigurim të nënshkrimit të krijuar në kuadër të kuptimit të nenit 2 (6) dhe (10) të Direktivës së EU-së 1999/93/EC; ose
- c) me mjetet e shkëmbimit elektronik të dhënave (EDI) ashtu siç është definuar në nenin 2 të Rekomandimin të Komisionit Evropian 1994/820/EC, lidhur me aspektet ligjore të shkëmbimit elektronik të të dhënave, kur marrëveshja e shkëmbimit ofrohet për shfrytëzimin e procedurave që garantojnë vërtetësinë e origjinës dhe tërësinë e të dhënave.

40.2. Faturat mund të dërgohen me anë të mjeteve të tjera elektronike me kusht që të pranohen me interesimin e klientit.

40.3. Kur grupet që i përfshinë disa fatura janë dërguar me anë të mjeteve elektronike të marrësi i njëjtë, detajet e përbashkëta për faturat e veçanta mund të përmenden vetëm një herë, nëse për secilën faturë të gjitha informacionet janë të pranueshme.

Neni 41

Ruajtja e faturave

41.1. Secili obligues tatimor duhet të sigurojë se kopjet e faturave që i ka lëshuara vetë dhe të gjitha faturat që ai i ka marrë, të ruhen sipas Kodit Tatimor të Kosovës, ashtu siç është miratuar nga Ministria për Ekonomi dhe Financa.

41.2. Obliguesi tatimor mund të vendosë për vendin e ruajtjes me kusht që ai të bëjë që faturat ose informacioni i ruajtur aty të jetë i qasshëm për autoritetet kompetente kurdo që ata kërkojnë një gjë të tillë.

41.3. Vërtetësia e origjinës dhe tërësia e përmbajtjes së faturave, gjithashtu edhe lexushmëria e tyre, duhet të garantohen gjatë tërë kohës sa ato ruhen. Në mënyrë që të sigurohet se këto kushte janë plotësuar, faturat mund të ruhen në formën e tyre origjinale në të cilën ato janë dërguar qoftë ato në formë elektronike apo në formë letre. Kur faturat ruhen me mjete elektronike, gjithashtu duhet të ruhen edhe të dhënat që garantojnë vërtetësinë e origjinës dhe tërësinë e përmbajtjes.

41.4. Ministria për Ekonomi dhe Financa duhet ta përcaktojë kohën për të cilën obliguesit tatimorë duhet t'i ruajnë faturat lidhur me mallrat dhe shërbimet e furnizimit në territorin e tyre dhe faturat e pranuar nga tatimpaguesit të vendosur në Kosovë.

41.5. Transmetimi dhe ruajtja e faturave “me mjete elektronike” nënkupton transmetimin ose vënien në dispozicion të pranuesit dhe ruajtjen duke shfrytëzuar pajisjen elektronike për procesim (duke përfshirë kompresimin digjital) dhe ruajtjen e të dhënave duke përdorur telat, radio transmetuesit, teknologjinë optike ose mjetet e tjera elektromagnetike.

PJESA E GJASHTË- PAGESA ELEKTRONIKE

Kapitulli XI

Parime të përgjithshme

Neni 42

Objektivi

42.1. Kjo pjesë e ligjit vendos kushtet që do të plotësohen nëse mënyrat e reja të pagesës elektronike do të zhvillohen në të mirë të të gjithë partnerëve ekonomikë dhe që krijojnë:

- a) për konsumatorët, siguri dhe komoditet;
- b) për tregtarët dhe lëshuesit, siguri më të madhe dhe produktivitet;
- c) për zhvillimin e industrisë në Kosovë.

42.2. Parimet e praktikave të drejta duhet të vëzhgohen nga ana e atyre që i fusin në funksion sistemet e pagesave me kartelë ose që mundësojnë të shfrytëzohen.

42.3. Zhvillimi teknologjik i mjeteve elektronike të pagesës duhet ta ketë parasysh dimensionin e tyre evropian: mjetet e tilla duhet të kenë ndërveprim të gjerë sa më shumë që të jetë e mundur, për të shmangur sistemet e izoluar dhe me këtë ndarjen e tregut.

Neni 43

Kontratat

43.1. Kontratat e lidhur nga lëshuesi ose agjentët tregtarët të tij dhe më konsumatorët, duhet të jenë në formë të shkruar dhe të rezultojnë në aplikim paraprak. Ato duhet të vendosen në detaje për kushtet e përgjithshme dhe për ato specifike të marrëveshjes.

43.2. Kontratat duhet të përpilohen në gjuhët zyrtare në Kosovë, ashtu siç definohet në Kornizën Kushtetuese (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9).

43.3. Çmimet duhet të definohen në mënyrë transparente, duke marrë parasysh kostot dhe rrezikun, por pa e kufizuar konkurrencën.

43.4. Të gjitha kushtet, nëse janë në përputhje me ligjin në zbatim lirisht duhet të negociohen dhe qartë të shprehen në kontratë.

43.5. Kushtet specifike për ndërprerjen e kontratës duhet të deklarohen, kurse palët duhet të njoftohen para se të lidhet një kontratë e tillë.

Neni 44 Ndërveprimi

Ndërveprimi duhet të jetë i plotë dhe të kryer ashtu që tregtarët dhe konsumatorët të mund të bashkohen në rrjetin ose të kontraktojnë me lëshuesin për zgjedhjen e tyre, duke qenë në gjendje që të gjitha pikat të jenë në gjendje t'i procesojnë kartelat e tyre.

Neni 45 Pajisja

45.1. Pikat e shitjes elektronike duhet të regjistrojnë, të kontrollojnë dhe t'i transmetojnë pagesat dhe të mund të integrohen në терминаlet e pikave të shitjes.

45.2. Tregtarët kanë mundësi të vendosin nëse dëshirojnë një terminal apo disa terminale të karteleve të llojeve të ndryshme

45.3. Tregtarët duhet të jenë të lirë të zgjedhin se cilin terminal të pikës së shitjes do ta vendosin. Ata duhet të kenë liri ta marrin me qera ose të blejnë një pajisje të tillë me kusht që vetëm të jetë certifikuar vetëm që t'i kënaqë kërkesat për sistemet e shitjes me shumicë dhe të mund të shfrytëzohet në baza ndërveprimi.

Neni 46 Mbrojtja dhe siguria e të dhënave

46.1. Pagesat elektronike në kohën e pagesës janë të pakthyeshme. Një porosi e vënë me mjete elektronike duhet të jetë e përvokueshme dhe nuk mund të jetë me urdhër anulimi.

46.2. Informacioni i transmetuar gjatë kohës kur bëhet pagesa për bankën përkatëse të tregtarit dhe më pas për lëshuesin, nuk duhet në asnjë mënyrë të ndikojë në mbrojtjen e fshehtësisë private. Duhet të jetë rreptësisht e kufizuar në atë që normalisht është paraqitur në çeqe ose transfere.

46.3. Çfarëdo problemi qoftë që ka të bëjë me mbrojtjen e informacionit ose me sigurinë haptas duhet të bëhet i njohur dhe të qartësohet në çfarëdo faze të kontratës ndërmjet palëve.

46.4. Kontratat nuk duhet ta kufizojë lirinë e tregtarit për të vepruar ose lirinë e konkurrencës.

Neni 47 Qasja e drejtë në sistem

47.1. Pa marrë parasysh madhësinë e tyre ekonomike, të gjitha ndërmarrjeve shërbyese duhet t'u lejohet qasje e drejtë në sistemin e pagesës elektronike. Tregtarit mund t'i refuzohet qasja vetëm për rastet e parapara në këtë ligj.

47.2. Nuk duhet të ketë dallim të pajustificueshëm në pagesë lidhur me transaksionet brenda Kosovës, gjithashtu edhe për pagesën për të njëjtat shërbime lidhur me transaksionet ndërkombëtare me vendet e tjera, veçanërisht me rajonin e afërt.

Kapitulli XII Dispozitat shitesë

Neni 48

Raportet ndërmjet dhënësve dhe tregtarëve

48.1. Për t'i dhënë shtytje qasjes reciproke ndërmjet sistemeve të ndryshme me kartela, kontratat ndërmjet dhënësve të kartelave dhe tregtarëve, nuk duhet të përmbajnë ndonjë përjashtim të pjesës tregtuese që kërkon nga tregtari të operojë sistemin me të cilin ka kontraktuar në marrëveshje.

48.2. Kontratat me tregtarët duhet të lejojnë konkurrencë efektive ndërmjet dhënësve të ndryshëm. Dispozitat detyrimisht duhet të kufizohet rreptësisht në kërkesat teknike, në mënyrë që të sigurohet se sistemi funksionon si duhet.

Neni 49

Raportet ndërmjet dhënësve dhe konsumatorëve

Në kontratën që ata e nënshkruajnë, pronarët e kartelave duhet t'i marrin të gjitha masat e nevojshme paraprakisht për ta garantuar sigurinë e kartelës së lëshuar dhe të njoftohen për kushtet e veçanta (humbje apo vjedhje).

Neni 50

Raportet ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve

Tregtarët duhet të paraqesin në mënyrë plotësisht të dukshme shenjat e kompanive me të cilat ata janë bashkuar, ata do të obligohen t'i pranojnë kartelat e tilla.

PJESA E SHITATË – PROCESIMI I TË DHËNAVE PERSONALE DHE MBROJTJA E FSHEHTËSISË SË TYRE

Kapitulli XIII

Mbrojtja e individëve dhe qarkullimi i lirë i të dhënave personale

Neni 51

Parimet e mbrojtjes së fshehtësisë së të dhënave personale

51.1. Në Kosovë, shërbimet e shoqërisë informatike duhet të ofrohen në përputhje me nevojën për mbrojtjen e të drejtat fundamentale dhe të lirive të personave fizikë dhe në mënyrë të veçantë të drejtën për mbrojtjen e fshehtësisë, kur ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale.

51.2. Pa marrë parasysh këtë parim, ofruesit e shërbimit nuk duhet ta kufizojnë e as ta ndalojnë qarkullimin e lirë të të dhënave personale brenda dhe jashtë Kosovës lidhur me arsyet që i përkasin mbrojtjes së sipërpërmendur.

51.3. Ky ligj zbatohet në tërësi ose pjesërisht për procesimin e gjitha të dhënave personale me anë të mjeteve automatike dhe për procesimin e ndryshëm me mjete të tjera nga ato automatike të të dhënave personale që formojnë një pjesë të një sistemi dozimi (arkivimi), plotësimi ose që janë përcaktuar të formojnë një pjesë të një sistemi të tillë.

51.4. Ky ligj nuk zbatohet për procesimin e të dhënave personale gjatë aktivitetit jashtë fushës së kompetencave të rezervuara, përderisa ato të mos barten te IPVQ-të. Për shembull: Procesimi i veprimeve lidhur me menaxhimin e emergjencave publike, mbrojtjes, sigurisë dhe aktiviteteve të UNMIK-ut dhe IPVQ-së në sferën e Ligjit për krimin. Ky ligj gjithashtu nuk zbatohet për procesimin e të dhënave personale nga personi fizik gjatë aktiviteteve të qarta personale ose aktiviteteve në shtëpi.

Neni 52

Rregullat e përgjithshme të ligjshmërinë së procesimit të të dhënave personale

52.1. Sa i përket cilësisë së të dhënave, ato duhet të jenë:

- a) të procesuara drejt dhe sipas ligjit;
- b) të mbledhura për qëllime specifike, të qarta dhe qëllime legjitime;
- c) adekuate, relevante dhe të mos tejkalojnë qëllimet për të cilat janë mbledhur ose dhe më tej të procesuara;
- d) të jenë të sakta dhe kur është e domosdoshme të jenë të freskuara;
- e) të mbahen në format që lejojnë identifikimin e subjekteve të të dhënave të kërkuara për kohë jo më të gjatë sesa është e domosdoshme për qëllimet për të cilat të dhënat janë mbledhur ose që procesohen më tutje.

52.2. Në të gjitha rastet e mbledhjes, të procesimit, ruajtjes ose të përhapjes së të dhënave personale, ofruesi i shërbimit të shoqërisë informatike duhet të krijojë “kontrolluesin” që të sigurojë përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 53

Kriteret për legjitimitet të procesimit të të dhënave

Të dhënat personale duhet të procesohen vetëm nëse:

- a) subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;
- b) procesimi është i domosdoshëm për përmbushjen e kontratës, për të cilën subjekti i të dhënave është palë e saj ose në mënyrë që të ndërmerren veprimet sipas kërkesës së subjektit të të dhënave para se ato të futen në kontratë;
- c) procesimi është i domosdoshëm në përputhje me obligimet ligjore, në të cilin kontrolluesi është subjekt;
- d) procesimi është i domosdoshëm në mënyrë që të mbrohen interesat vitale të subjektit të të dhënave;
- e) procesimi është i domosdoshëm për kryerjen e detyrës që bëhet për interes publik ose për ta ushtruar autoritetin e dhënë zyrtar që i lejohet kontrolluesit ose palës së tretë, së cilës i zbulohen të dhënat;
- f) procesimi është i domosdoshëm për qëllime interesash legjitime të ushtruara nga kontrolluesi ose nga pala e tretë ose nga palët të cilave u janë zbuluar të dhënat, përveç nëse interesat e tilla shkelin të drejtat dhe liritë fundamentale të subjektit të të dhënave që kërkojnë mbrojtje sipas nenit 51 të këtij ligji.

Neni 54
Procesimi i kategorive të veçanta të të dhënave

54.1. Procesimi i të dhënave personale ndalohe nëse zbulon:

- a) origjinën raciale ose etnike;
- b) opinionet politike;
- c) besimet religjioze ose filozofike;
- d) anëtarësinë në sindikatat e punëtorëve;
- e) shëndetin ose jetën seksuale.

54.2. Kufizimet e imponuara ,sipas paragrafit-1 nuk zbatohen kur:

- a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin qartë për procesimin e këtyre të dhënave, përveç kur ligjet e zbatueshme në Kosovë sigurojnë që ndalimi i referuar më sipër nuk mund të hiqet nga pëlqimi i subjektit të të dhënave;
- b) procesimi është i domosdoshëm për qëllimet e kryerjes së obligimeve dhe të drejtave specifike të kontrolluesit të sferës së ligjit të punës derisa është i autorizuar nga ligji i aplikueshëm në Kosovë që të sigurojë mbrojtje adekuatë;
- c) Procesimi është i domosdoshëm për të mbrojtur interesat vitale të subjektit të të dhënave ose të personit tjetër ku subjekti i të të dhënave fizikisht ose me ligj është në pamundësi ta japë pëlqimin e tij;
- d) Procesimi është kryer në rrjedhën e aktiviteteve të tij legjitime me garanci të duhura nga një fondacion, shoqatë ose nga ndonjë organ tjetër joprofitabil me qëllim politik, filozofik, religjioz ose të sindikatave dhe me kusht që procesimi ka të bëjë vetëm me anëtarët ose me personat e entitetit që kanë kontakt të rregullt me të në lidhje me qëllimet e tij dhe që të dhënat nuk janë zbuluar për një palë të tretë pa pëlqimin e subjekteve të të dhënave;
- e) Procesimi ka të bëjë me të dhënat që janë bërë publike nga subjekti i të dhënave ose që është e domosdoshme për themelimin, ushtrimin ose mbrojtjen e kërkesave ligjore;
- f) Procesimi i të dhënave kërkohet për qëllime të mjekësisë preventive, për diagnoza mjekësore dhe për ofrimin e kujdesit a të trajtimit mjekësor ose menaxhmentit të shërbimeve shëndetësore, kur këto të dhëna procesohen nga profesionistët shëndetësorë që u nënshtrohen ligjit ose rregullave të krijuara nga organet kompetente për obligimin e fshehtësisë profesionale ose nga një person tjetër që gjithashtu i nënshtrohet obligimit të fshehtësisë.

Neni 55
Informacioni që duhet t'i jepet subjektit të dhënave

55.1. Kontrolluesi ose përfaqësuesi i tij duhet t'i ofrojë subjektit të dhënave nga i cili të dhënat që kanë të bëjnë me të, janë mbledhur së paku informata, si vijim:

- a) identiteti i kontrolluesit ose i përfaqësuesit të tij nëse ka;
- b) qëllimet e procesimit për të cilat të dhënat janë caktuar;
- c) çfarëdo informacioni si është:

- (i) pranuesit ose kategoritë e pranuesve të dhënave;
 - (ii) nëse u përgjigjet pyetjeve që mund të jenë obligative ose vullnetare;
 - (iii) pasojat e mundshme për dështim të përgjigjes;
- d) Ekzistenca e së drejtës për qasje dhe e drejta për t'i korigjuar të dhënat që kanë të bëjnë me të.

55.2. Kur të dhënat nuk janë marrë nga subjekti i të dhënave, kontrolluesi ose përfaqësuesi i tij në kohën kur është bërë regjistrimi i të dhënave personale ose nëse është paraparë që ato duhet t'i zbulohen një pale të tretë jo më vonë se në datën kur për herë të parë të dhënat janë zbuluar, t'i ofrohen subjektit të dhënave me më të paktën një informacion, në vazhdim:

- a) identitetin e kontrolluesit ose të përfaqësuesit të tij, nëse ka;
- b) qëllimin e procesimit;
- c) çfarëdo informacioni sikurse:
 - (i) kategoria e të dhënave për të cilat është brengosur;
 - (ii) pranuesi ose kategoritë e pranuesve;
- d) ekzistenca e së drejtës për qasje dhe e drejta e korigjimit të dhënave lidhur me të.

Neni 56

E drejta e subjektit të dhënave për qasje në të dhëna

Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të marrë nga kontrolluesi:

- a) pa ndonjë detyrim në kohë të arsyeshme dhe pa vonesa ose pa shpenzime të mëdha;
- b) konfirmimin se të dhënat lidhur me të janë ose nuk janë procesuar ende dhe së paku informatat për qëllimet e procesimit, kategoritë e të dhënave në fjalë dhe pranuesit ose kategoritë e pranuesve të cilëve u janë zbuluar këto të dhëna;
- c) komunikimin me të në formë të kuptueshme të të dhënave që kalojnë nëpër procesim dhe çfarëdo informacioni tjetër në dispozicion, si burim të tyre;
- d) njohurinë e logjikes së përfshirë në ndonjë procesim automatik të dhënave lidhur me atë, të paktën në rastin e vendimeve automatike;
- e) kur korigjimi, fshirja ose bllokimi i të dhënave është i përshtatshëm, procesimi i të cilave nuk përputhet me dispozitat e këtij ligji, në veçanti për shkak të natyrës së pakompletuar ose të pasaktësisë së të dhënave;
- f) njoftimin për palët e treta të cilave u janë zbuluar të dhëna të çfarëdo korigjimi, fshirje apo bllokime të kryera në përputhje me atë që veç është cekur përveç nëse kjo tregohet si e pamundur apo përfshin përpjekje joproporcionale.

Neni 57
Kufizimet dhe përjashtimet

57.1. Obligimet e detyrueshme të këtij ligji në lidhje me të dhënat personale dhe me mbrojtjen e tyre është pa prejjudikim për kompetencat e rezervuara të UNMIK-ut, kur kufizimi i tillë përfshinë masat e domosdoshme për t'i ruajtur:

- a) mbrojtjen dhe sigurinë publike;
- b) preventivën, hetuesinë, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale kriminale ose shkeljen e etikës për profesionet e rregulluara;
- c) rëndësinë ekonomike ose interesin financiar të UNMIK-ut në emër të Kosovës duke përfshirë çështjet monetare, buxhetore dhe tatimore;
- d) lidhur me funksionin e monitorimit, inspektimit apo rregullimit qoftë edhe rastësisht, me ushtrimin e autoritetit zyrtar për rastet e referuara në (b), (c) dhe (d);
- e) mbrojtjen e subjektit të të dhënave apo të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

57.2. Në bazë të mbrojtjes adekuate ligjore, veçanërisht ato të dhëna që nuk janë shfrytëzuar për marrjen e masave ose të vendimit lidhur me çfarëdo individ në veçanti, të dhënat që janë procesuar vetëm për qëllimet e hulumtimeve shkencore ose janë mbajtur në formën personale për kohën që nuk e kalon kohën domosdoshme për qëllimin e vetëm të përftohen të dhënave statistikore, do të përjashtohen nga kufizimet e këtij kapitulli.

Neni 58
E drejta e subjektit të dhënave të kundërshtojë

Subjekti i të dhënave ka të drejtë:

- a) në raste të caktuara të përmendura në nenin 53 për kriteret e legjitimitetit e të procesimit të dhënave për të kundërshtuar mbi baza legjitime të detyrueshme lidhur me situatën e tij të veçantë, për procesimin e të dhënave që kanë të bëjnë me të, me përjashtim kur është paraparë ndryshe me ligjin e aplikueshëm;
- b) të kundërshtojë procesimin e të dhënave personale që kontrolluesi i parasheh të procesohen për qëllime marketingu direkt ose për të qenë i informuar para se të dhënat personale të zbulohen për herë të parë për palët e treta, ose të shfrytëzohen në emër të tyre për qëllimet e marketingut direkt dhe të ofrohet në mënyrë të qartë e drejta që të kundërshtojë pa detyrime për zbulimet ose për shfrytëzimet e tilla.

Neni 59
Fshehtësia dhe siguria e procesimit

59.1. Çdo njeri që vepron nën autoritetin e kontrolluesit ose të proceduesit, duke përfshirë edhe vetë procesuesin që ka qasje në të dhënat personale, nuk duhet t'i procesojë ato përveç nëse udhëzohet nga kontrolluesi, vetëm në rast kur atij i kërkohet të veprojë sipas ligjit.

59.2. Kontrolluesi duhet të zbatojë masa të duhura teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale ndaj shkatërrimit aksidental ose atij jo të ligjshëm, ose humbjes aksidentale, ndryshimi, zbulimi ose në veçanti qasja e paautorizuar kur procesimi përfshin transmetimin e të dhënave përmes rrjetit dhe kundër të gjitha formave të tjera të pa ligjshme të procesimit.

59.3. Procesimi me anë të procesorit duhet të drejtohet nga një kontratë ose akti ligjor që e lidh procesorin me kontrolluesin dhe përcakton në veçanti se:

- a) procesori duhet të veprojë vetëm sipas udhëzimeve të kontrolluesit;
- b) obligimet e paraqitura në paragrafin(2) gjithashtu duhet të jenë detyrë e procesuesit.

Neni 60

Obligimi për të njoftuar autoritetin mbikëqyrës

60.1. Kontrolluesi ose nëse ka përfaqësuesin e tij, duhet ta njoftojë autoritetin mbikëqyrës që referohet në nenin 70 para kryerjes së veprimit procedues që është plotësisht ose pjesërisht i automatizuar ose një sërë veprimesh të tilla që t'i shërbejë një qëllimi të vetëm ose në lidhje me disa qëllime.

60.2. Autoriteti mbikëqyrës mund të ofrojë për thjeshtësim ose përjashtim nga njoftimi vetëm në rastet dhe nën kushtet si vijon:

- a) kur për kategoritë e veprimeve të procesimit që kanë gjasë të vogël, duke marrë parasysh të dhënat që do të procesohen, për të ndikuar negativisht në të drejtat dhe liritë e subjekteve të dhënave, ato specifikojnë qëllimet e procesimit, të dhënat ose kategoritë e të dhënave që kalojnë nëpër procesim, kategoria ase kategoritë e subjektit të dhënave, të pranuesve ose të kategorive të pranuesve të cilëve do t'u zbulohen të dhënat dhe kohëzgjatjen gjatë së cilës do të ruhen të dhënat ose
- b) kur kontrolluesi në përputhje me ligjin e zbatueshëm që e udhëheq atë cakton një zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale, përgjegjës në veçanti:
 - (i) për të siguruar në mënyrë të pavarur zbatimin e brendshëm të akteve normative të zbatueshme në mbështetje të këtij ligji.
 - (ii) për mbajtjen e regjistrit të veprimeve të procesimit që bëhen nga kontrolluesi, ku duke përmbajtur pikat e informacionit që i referohet nenin 20 (2) të ligjit.
 - (iii) në këtë mënyrë duke ua siguruar të drejtat dhe liritë subjekteve të të dhënave kanë gjasë të vogël të ndikojnë negativisht në veprimin e procesimit.

60.3. Paragrafi (1) nuk zbatohet në procedimin, qëllimi i vetëm i të cilit është mbajtja e regjistrit që sipas legjislacionit në fuqi është i përcaktuar të sigurojë informacione publikut dhe që është i hapur për konsultime qoftë nga publiku në përgjithësi ose nga çdo person që paraqet interes legjitim.

60.4. Disa ose të gjitha veprimet e procesimit jo automatik që përfshin të dhënat personale, do të njoftohen dhe do të sigurohen për këto veprime të procesimit , që të jenë lëndë e njoftimit të thjeshtë.

Neni 61

Përmbajtja e njoftimit

61.1. Informatat që duhet të jepen në njoftim, duhet të përfshijnë së paku:

- a) emrin dhe adresën e kontrolluesit dhe nëse ka të përfaqësuesit të tij;
- b) qëllimin e procesimit;
- c) përshkrimin e kategorisë ose të kategorive të subjektit të të dhënave dhe të dhënave;

- d) kategoritë e të dhënave që kanë të bëjnë me to;
- e) pranuesit ose kategoritë e pranuesit të cilit këto të dhëna mund t'i zbulohen;
- f) transferimin e propozuar të dhënave në vendet e treta;
- g) një përshkrim të përgjithshëm që mundëson t'u bëhet një vlerësim paraprak përshtatjes së masave të ndërmarra sipas nenit 16 që të garantojë siguri të procesimit.

61.2. Autoriteti mbikëqyrës duhet ta specifikojë procedurën, sipas së cilës çdo ndryshim që ka ndikim në informacionet që referohen në paragrafin (1), duhet të njoftohen.

Neni 62 Kontrolli paraprak

62.1. Autoriteti mbikëqyrës duhet t'i përcaktojë veprimet e procesimit që mund të paraqesin rrezik specifik për të drejtat dhe liritë e subjekteve të dhënave dhe duhet të kontrollojë që këto veprime të procesimit janë ekzaminuar para se të fillohet.

62.2. Kontrollimet e tilla paraprake duhet të kryhen nga autoriteti mbikëqyrës posa ta ketë marrë njoftimin nga kontrolluesi ose nga zyrtari për mbrojtjen e të dhënave që në rast dyshimi duhet ta konsultojë autoritetin mbikëqyrës.

62.3. Autoriteti mbikëqyrës mund të kryejë kontrollimet e tilla në kontekst të përgatitjes qoftë siç është udhëzuar nga ligji i shpallur ose nga aktet pasuese normative, që përkufizojnë natyrën e procesimit dhe parashtrajnë mbrojtjen adekuate.

Neni 63 Publikimi i veprimeve procesuese

63.1. Autoriteti mbikëqyrës duhet ta ruajë një regjistër ose një përmbledhje të veprimeve të procesimit të njoftuar sipas nenit 60. Regjistri duhet të përmbajë së paku informatat e shënuar sipas nenit 61. Regjistri mund të inspektohet nga çdo person.

63.2. Për veprimet e procesimit që nuk i nënshtrohen njoftimit të kontrolluesit ose ndonjë organi tjetër të emëruar nga Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit duhet t'i verë në dispozicion së paku informatat duke iu referuar nenit 61 (5 pikat e para) në formë të përmbledhjes së shkurtër të arsyeshme në kërkesë të çdo personi.

63.3. Kjo dispozitë nuk zbatohet në procesimin qëllimi i vetëm i së cilës është mbajtja e regjistrit që sipas legjislacionit në fuqi është i përcaktuar që të sigurojë informata për publikun dhe i cili është i hapur për konsultim qoftë nga publiku në përgjithësi apo nga çdo person që mund të ofrojë dëshmi për interesin legjitim.

Kapitulli XIV Procedura ankimore

Neni 64 Kompensimet

64.1. Mbrojtja e të drejtave të përcaktuara me këtë ligj, para se të apelohe në gjyqin kompetent sigurohet në shkallë të parë nga Autoriteti Mbikëqyrës (neni 70 i këtij ligji) dhe në shkallë të dytë nga Autoriteti Rregullativ për Telekomunikacion.(ART- Rregullorja nr. 2003/16).

64.2. Personi që konsideron se i janë shkelura të drejtat e njohura me këtë ligj apo nuk është i kënaqur me shërbimet e ofruesit, ka të drejtë të ankohet në Autoritetin Mbikëqyrës që është i obliguar të zgjidhë ankesën në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të ankesës.

64.3. Kundër vendimit të Autoritetit Mbikëqyrës personi i pa kënaqur ka të drejtë që në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit të ushtroi ankesë te Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit, e që është i obliguar të vendos lidhur me ankesën në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të ankesës.

64.4. Vendimi i ART-së lidhur me ankesat mund të kontestohen në Gjykatën kompetente sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative në fuqi.

Neni 65 Përgjegjësia

65.1. Çdo personi që ka pësuar dëmtim si rezultat i një veprimi të paligjshëm të procesimit me këtë ligj ka të drejtë të marrë kompensim nga kontrolluesi për dëmtimin e pësuar.

65.2. Kontrolluesi mund të përjashtohet nga kjo përgjegjësi plotësisht ose pjesërisht nëse dëshmon se nuk është përgjegjës për shkaqet që e sollën dëmtimin.

Neni 66 Sanksionet

Sanksionet që do të vihen në rast të shkeljes së dispozitave të miratuara në vijim të këtij ligji, duhet të zhvillohen nga autoriteti kompetent mbikëqyrës dhe do të jenë efektive me miratimin me shkrim nga Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit.

Kapitulli XV Transferimi i të dhënave personale në vendet e treta

Neni 67 Parimet

67.1. Transferimi në një vend të tretë i të dhënave personale që kalojnë nëpër procesim ose që janë përcaktuar për t'u procesuar pas transferimit, mund të ndodhë pa prejudikuar pajtueshmërinë me këtë ligj vetëm në rastin, kur shteti i tretë në fjalë siguron nivel përkatës të mbrojtjes.

67.2. Niveli i duhur i mbrojtjes i dhënë nga vendi i tretë duhet të vlerësohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat që e rrethojnë një veprim të transferimit të të dhënave ose një sërë veprimesh të transferimit të të dhënave; vëmendje të veçantë duhet t'u kushtohet natyrës së të dhënave, qëllimit dhe kohëzgjatjes së veprimit ose veprimeve të propozuara të procesimit, vendit të prejardhjes dhe vendit të fundi të destinimit, rregullave të ligjit, ato të përgjithshme dhe sektoriale që janë në fuqi në vendin e tretë në fjalë dhe rregullave profesionale dhe masave të sigurisë që zbatohen brenda atij vendi.

Neni 68 Përbashkrimet

68.1. Përveç rasteve sipas nenit 67, ruhen edhe të dhënat tjera, po që se ofrohen ndryshe me ligjin në fuqi e që rregullon rastet e veçanta të bartjes së të dhënave personale në një vend të tretë, por që nuk garanton nivel adekuat të besueshmërisë në kuptim të nenit 24 të këtij ligji, me kusht që:

- a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për transferimin e propozuar ose :
- b) transferimi është i domosdoshëm për ekzekutimin e kontratës ndërmjet subjektit të dhënave dhe kontrolluesit ose zbatuesit e masave para kontraktuese që jepen si përgjigje me kërkesë të subjektit të dhënave; ose
- c) transferimi është i domosdoshëm për përfundimin ose përmbarimin e kontratës të arritur në interes të subjektit të dhënave ndërmjet kontrolluesit dhe palës së tretë; ose
- d) transferimi është i domosdoshëm ose kërkohet sipas ligjit për çështjet të rëndësishme për interesin publik ose për krijimin, ushtrimin apo mbrojtjen e kërkesave ligjore; ose
- e) transferimi është i domosdoshëm në mënyrë që të mbrohen interesat jetësore të subjektit të të dhënave; apo
- f) transferimi është bërë nga regjistri që sipas ligjeve ose rregulloreve është përcaktuar të ofrojë informacion për publikun dhe që është i hapur për konsultim qoftë nga publiku në përgjithësi ose nga çdo person që mund të paraqet interesa legjitime deri në masën që kushtet e paraqitura në ligj për konsultim janë plotësuar për rastin e veçantë.

68.2. Pa prejudikuar paragrafin (1), transferimi ose grup transferimesh i të dhënave personale te një vend i tretë, që nuk garanton nivel përkatës të mbrojtjes, mund të ndodhë kur kontrolluesi sjell mbrojtje përkatëse për mbrojtjen e fshehtësisë dhe të drejtave e të lirive të individëve dhe për sa i përket ushtrimin të drejtave që korrespondojnë; mbrojtjet e tilla mund të rezultojnë në veçanti, nga klauzolat e duhura kontraktuese.

Neni 69 Kodet e sjelljes

69.1. Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit mund të nxjerr kodet e sjelljes për autoritetin mbikëqyrës që janë përcaktuar që të kontribuojnë për zbatimin përkatës të këtij ligji, duke marrë parasysh vetitë specifike të sektorëve të ndryshëm.

69.2. Ministria mund t'u lejojë shoqatave tregtare dhe organeve të tjera që përfaqësojnë kategoritë e tjera të kontrolluesve që kanë përpiluar projekt kodet ose që kanë për synim ndryshimin ose zgjerimin e kodeve ekzistuese, për të qenë në gjendje t'i dorëzojnë për zbatimin nga autoriteti mbikëqyrës.

Neni 70
Autoriteti mbikëqyrës për mbrojtjen e individëve
sa i përket procesimit të të dhënave personale

70.1. Ministria e Transportit dhe e Postë-Telekomunikacionit do të autorizojë një ose më shumë autoritete kompetente të jenë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji.

70.2. Autoritetet mbikëqyrëse duhet të konsultohen kur të përpilohen masat administrative ose rregulloret lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të individëve dhe sa i përket procesimit të të dhënave personale.

70.3. Secili autoritet mbikëqyrës duhet veçanërisht të pajiset me:

- a) kompetenca hetuesie, siç janë kompetencat për qasje në të dhënat që formojnë lëndën e çështjes së veprimeve procesuese dhe kompetenca për mbledhjen e të gjitha informatave të domosdoshme për kryerjen e detyrave të tij mbikëqyrëse;
- b) kompetencat efektive për ndërhyrje, siç janë për shembull, për dërgimin e opinionëve para se veprimet e procesimit të jenë bërë dhe duke siguruar publikim adekuat të opinionëve të tilla, të urdhrimit të bllokimit, fshirjes ose shkatërrimit të të dhënave, vënies së ndalesës së përkohshme ose të përhershme për procesimin, për të njoftuar apo paralajmëruar kontrolluesin, ose dërgimin e çështjes në parlamentet kombëtare ose në institucionet e tjera politike;
- c) kompetencë për t'u ndërlidhur me procedurat ligjore kur dispozitat e miratuara sipas këtij ligji janë shkelë ose që këto shkelje të sillen para autoriteteve gjyqësore.

70.4. Secili autoritet mbikëqyrës dëgjon ankesat e paraqitura nga çdo person ose nga ndonjë shoqatë që e përfaqëson atë person lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tij lidhur me procesimin e të dhënave personale. Personi në fjalë duhet të informohet për rezultatin e ankesës së tij.

Kapitulli XVI
Procesimi i të dhënave personale dhe ruajtja e fshehtësisë
në Sektorin e komunikimeve elektronike

Neni 71
Fushëveprimi dhe trajtimi

71.1. Ky ligj duhet të sigurojë nivel të barabartë të mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive themelore, veçanërisht të drejtën e fshehtësisë së procesimit të të dhënave personale në sektorin e komunikimit elektronik dhe të sigurojë lëvizje të lirë të të dhënave të tilla dhe të pajisjeve komunikuese elektronike dhe shërbimeve brenda dhe jashtë Kosovës.

71.2. Dispozitat e këtij ligji ofrojnë mbrojtjen e interesave legjitime të parapaguesve që janë persona juridikë.

71.3. Ky ligj nuk zbatohet për aktivitetet që kanë të bëjnë me sigurinë publike, me mbrojtjen a më sigurinë shtetërore (duke përfshirë mbarëvajtjen ekonomike të Kosovës kur aktivitetet kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë) dhe aktivitetet në sferat e së drejtës penale.

Neni 72
Fushëveprimi i shërbimeve

72.1. Ky ligj zbatohet për procesimin e të dhënave personale në lidhje me dispozitat e mundshme publike të shërbimeve të komunikimit elektronik në rrjetet e komunikimit publik në Kosovë.

72.2. Nenet 7, 9 dhe 10 do të zbatohen për linjat e parapaguesit që janë të lidhura me shkëmbimet digjitale dhe, aty ku teknikisht është e mundur dhe nuk ka shpenzime të mëdha, për linjat e parapaguesve që janë të lidhura me shkëmbimet analoge.

Neni 73
Siguria

73.1. Ofruesi i mundshëm publik i shërbimit të komunikimeve elektronike duhet të ndër marrë masa adekuate teknike dhe organizative për t'i mbrojtur sigurinë e shërbimeve. Duke pasur parasysh vlerën dhe koston e zbatimit, këto masa do të siguronin një nivel të duhur të sigurisë për rrezikun e paraqitur.

73.2. Në rast të rrezikut të veçantë të prishjes të sigurisë së rrjetit, ofruesi i mundshëm publik i shërbimit të komunikimeve elektronike duhet t'i informojë parapaguesit lidhur me një rrezik të tillë dhe, aty ku rreziku qëndron jashtë sferës së masave që do të merren nga ofruesi i shërbimit, për ndonjë zgjidhje (kompensim) të mundshëm, duke përfshirë një tregues të kostove që ka mundësi të përfshihen.

Neni 74
Fshehtësia e komunikimit

74.1. Fshehtësia e komunikimit dhe e të dhënave të qarkullimit të një rrjeti publik komunikues dhe shërbimeve të mundshme publike të komunikimit elektronik, duhet të mbrohen nga ofruesi i shërbimit. Veçanërisht, ofruesit e shërbimit duhet ta ndalojnë përgjimin, ndërhyrjen në bisedën telefonike, ruajtjen ose format e tjera të kapjes ose të vëzhgimit të komunikimeve dhe të dhënave të qarkullimit lidhur me të nga personat me përjashtim të shfrytëzuesve, pa pëlqim të shfrytëzuesve që u përket kjo, përveç nëse ka autorizim nga gjyqi që të bëjë një gjë të tillë. Kjo nuk parandalon ruajtjen teknike të domosdoshme për bartjen e komunikimit pa paragjykuar parimin e fshehtësisë.

74.2. Paragrafi (1) nuk pengon ndonjë autorizim ligjor për regjistrimin e komunikimeve dhe të të dhënave të qarkullimit kur kjo kryhet në rrjedhën e praktikës ligjore të biznesit për qëllimin e ofrimit të dëshmisë së transaksioneve komerciale ose për ndonjë komunikim tjetër biznesi.

74.3. Shfrytëzimi i rrjeteve të komunikimit elektronik për të ruajtur informacionin ose për të fituar qasje në informacionin e ruajtur në pajisjen terminale të një parapaguesi ose shfrytëzuesi i lejohet vetëm me kusht që parapaguesi ose shfrytëzuesi që i përket ajo është i informuar qartë dhe në mënyrë të plotë me informacionin në përputhje me këtë ligj, ndër të tjera me qëllimet e procesimit, dhe i ofrohet e drejta për të refuzuar një procesim të tillë nga kontrolluesi i të dhënave. Kjo nuk parandalon ndonjë ruajtje teknike ose qasje vetëm për qëllime të kryerjes ose të lehtësimit të transmetimit të komunikimit përmes një rrjeti të komunikimit elektronik, ose pikërisht si e domosdoshme në mënyrë që të ofrohet një shërbim i shoqërisë informatike i kërkuar, në mënyrë të qartë nga parapaguesi ose shfrytëzuesi.

Neni 75

Të dhënat e dërguara

75.1. Të dhënat e dërguara të procesuara dhe të ruajtura lidhur me parapaguesit dhe shfrytëzuesit nga ofruesi i rrjetit të komunikimit publik ose të shërbimit të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut duhet të fshihen ose të bëhen anonime kur nuk janë më të nevojshme për qëllimin e transmetimit të një komunikimi.

75.2. Të dhënat e dërguara të domosdoshme për qëllimet e faturimit të parapaguesit dhe pagesave për ndërlidhje mund të procesohen. Një procesim i tillë është i lejueshëm vetëm deri në fund të periudhës gjatë së cilës fatura mundet sipas ligjit të kundërshtohet ose të paguhet.

75.3. Për qëllim marketingu të shërbimit komunikues elektronik ose për ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar, ofruesi i shërbimit të komunikimit elektronik në dispozicion për publikun mund t'i procesojë të dhënat e referuara në paragrafin (1) deri në masën dhe kohëzgjatjen e duhur për shërbimet e tilla ose marketingun, nëse parapaguesi ose shfrytëzuesi me të cilin të dhënat kanë të bëjnë ka dhënë pëlqimin e tij ose të saj. Shfrytëzuesve ose parapaguesve duhet t'u jepet mundësia për ta tërhequr pëlqimin e tyre për procesimin e të dhënave të dërguara në çfarëdo kohe.

75.4. Ofruesi i shërbimit duhet ta informojë parapaguesin ose shfrytëzuesin për llojet e të dhënave të dërguara që janë procesuar dhe kohëzgjatjen e procesimeve të tilla për qëllimet e përmendura në paragrafin (2) dhe, para marrjes së pëlqimit, për qëllimet e përmendura në paragrafin (3).

75.5. Procesimi i të dhënave të dërguara, në përputhje me paragrafët e mëparshme në këtë nen, duhet të kufizohet për personat që veprojnë sipas autoritetit të ofruesve të rrjeteve të komunikimeve publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut në trajtimin e faturimit ose menaxhimin e qarkullimit, pyetjeve të konsumatorit, zbulimin e mashtrimit, shërbimet e marketingut të komunikimeve elektronike ose ofrimin e një shërbimi me vlerë të shtuar, dhe duhet të kufizohen në atë që është e domosdoshme për qëllimet e aktiviteteve të tilla.

75.6. Paragrafët (1), (2), (3) dhe (5) duhet të zbatohen pa paragjykuar në mundësinë e entiteteve kompetente për të qenë të informuara për të dhënat e qarkullimit në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm me synimin për të zgjidhur mosmarrëveshjet, veçanërisht mosmarrëveshjet e ndërlidhjes ose faturimit.

Neni 76

Faturimi i specifikuar

Parapaguesit duhet të kenë të drejtë t'i marrin faturat e paspecifikuara. Ofruesit e shërbimit duhet t'u ofrojnë shfrytëzuesve të drejtën e intimitetit për thirrjen e shfrytëzuesve dhe parapaguesve që janë thirrur, p.sh duke u siguruar se metodat alternative të shtimit të mjaftueshëm të fshehtësisë për komunikim ose pagesa të jenë në dispozicion për shfrytëzuesit dhe parapaguesit e tillë.

Neni 77

Paraqitja dhe kufizimi i identifikimit të thirrjes dhe linjës së lidhur

77.1. Aty ku ofrohet paraqitja e identifikimit të linjës thirrëse, ofruesi i shërbimit duhet t'i ofrojë shfrytëzuesit të thirrjes mundësinë, me përdorimin e një mënyre të thjeshtë dhe pa pagesë, të parandalimit të paraqitjes së identifikimit të linjës thirrëse në baza të çdo thirrjeje. Parapaguesi i thirrjes duhet të ketë mundësi në bazë të çdo linje.

77.2. Aty ku ofrohet paraqitja e identifikimit të linjës thirrëse, ofruesi i shërbimit duhet t'i ofrojë shfrytëzuesit të thirrjes mundësinë, me përdorimin e një mënyre të thjeshtë dhe pa pagesë për përdorimin e arsyeshëm të këtij funksioni, të parandalimit të paraqitjes së identifikimit të linjës thirrëse të thirrjeve hyrëse.

77.3. Aty ku ofrohet paraqitja e identifikimit të linjës thirrëse dhe ku identifikimi i linjës thirrëse është paraqitur para se të bëhet thirrja, ofruesi i shërbimit duhet të ofrojë mundësinë për parapaguesit të thirrur, me përdorimin e një mënyre të thjeshtë, refuzimin e thirrjeve hyrëse aty ku paraqitja e identifikimit të linjës thirrëse është parandaluar nga shfrytëzuesi ose parapaguesi i thirrjes.

77.4. Aty ku është ofruar paraqitja e identifikimit të linjës së lidhur, ofruesi i shërbimit duhet t'i ofrojë parapaguesit të thirrur mundësinë, me përdorimin e një mënyre të thjeshtë dhe pa pagesë, të parandalimit të paraqitjes së identifikimit të linjës së lidhur për shfrytëzuesin që thërret.

77.5. Aty ku paraqitja e thirrjes dhe/ose identifikimi i linjës së lidhur është ofruar, ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut duhet ta informojnë publikun edhe për mundësitë e paraqitura në paragrafët (1), (2), (3) dhe (4).

Neni 78

Të dhënat për lokacionin të ndryshme nga të dhënat e dërguara

78.1. Kur të dhënat për lokacionin të ndryshme nga të dhënat e dërguara, në lidhje me shfrytëzuesit ose parapaguesit e rrjetave publike të komunikimeve ose të shërbimeve elektronike të komunikimit në dispozicion për publikun, që mund të procesohen, të dhënat e tilla mund të procesohen vetëm kur ato bëhen në mënyrë anonime, ose me pëlqimin e shfrytëzuesve a të parapaguesve deri në atë masë dhe për kohën e nevojshme për ofrimin e shërbimit për vlerën e shtuar.

78.2. Ofruesi i shërbimit duhet t'i informojë shfrytëzuesit ose parapaguesit, para marrjes së pëlqimit të tyre, për llojin e vendit të dhënave të ndryshme nga të dhënat në dërgim që do të procesohen, për qëllimet dhe kohëzgjatjen e procesimit dhe nëse të dhënat do të transmetohen te një palë e tretë për qëllimin e ofrimit të shërbimit të vlerës së shtuar.

78.3. Shfrytëzuesit ose parapaguesit duhet t'u jepet mundësia e tërheqjes së pëlqimit të tyre për procesimin e të dhënave të vendosura të ndryshme nga të dhënat e dërguara në çfarëdo kohe.

78.4. Aty ku pëlqimi i shfrytëzuesve ose i parapaguesve është marrë për procesimin e të dhënave të vendosura të ndryshme nga të dhënat e qarkullueshme, shfrytëzuesi apo parapaguesi duhet të vazhdojë të ketë mundësinë, duke shfrytëzuar një mënyrë të thjeshtë

dhe pa pagesë, që përkohësisht të refuzoj procesimin e të dhënave të tilla për secilën lidhje në rrjetë ose për secilën transmetim të një komunikimi.

78.5. Procesimi i të dhënave të vendosura të ndryshme nga të dhënat e qarkullueshme në përputhje me paragrafet (1),(2),(3) dhe (4) duhet të kufizohet për personat që veprojnë sipas autoritetit të ofruesit të rrjetit të komunikimit publik ose shërbimit të komunikimeve në dispozicion për publikun apo për palën e tretë duke ofruar shërbimin e vlerës së shtuar, dhe duhet të kufizohet në atë që është e domosdoshme për qëllimet e ofrimit të shërbimit të vlerës së shtuar.

Neni 79 Përfshirjet

Në rastet specifike, ofruesi i rrjetit të komunikimit publik dhe/ose shërbimi i komunikimit elektronik në dispozicion të publikut mund t'i refuzojë dispozitat e nenit 68 dhe 69:

- a) eliminimi i paraqitjes së identifikimit të linjës thirrëse, mbi baza të përkohshme, në aplikimin e kërkesës së parapaguesit për gjurmimin e thirrjeve të bezdisshme ose me qëllim të keq. Në këtë rast, të dhënat që përmbajnë identifikimin e parapaguesit të thirrur do të ruhen dhe do të jenë në dispozicion nga ofruesi i rrjetit të komunikimit publik dhe/ose shërbimit të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/16,
- b) eliminimi i paraqitjes së identifikimit të linjës thirrëse dhe mohimi i përkohshëm ose mungesa e pëlqimit të parapaguesit ose shfrytëzuesit për procesimin e të dhënave të vendosura, në bazë të çdo linje për organizatat që merren me thirrjet emergjente dhe të njohura si të tilla sipas ligjit në zbatim në Kosovë, duke përfshirë zbatuesin e ligjit, shërbimet e ambulancës dhe të zjarrfikësve, për qëllimet e përgjigjes ndaj thirrjeve të tilla.

Neni 80 Transferi automatik i thirrjes

Ofruesit e shërbimit duhet të sigurojnë që cilido parapagues të ketë mundësi, duke shfrytëzuar mënyra të thjeshta dhe pa pagesë, të ndalimit të transferimit automatik të thirrjes së bërë nga pala e tretë nga terminali i shfrytëzuesit.

Neni 81 Numërori telefonik i parapaguesve

81.1. Ofruesit e shërbimit duhet të sigurojnë që parapaguesit të jenë të informuar, pa pagesë dhe para se ata të përfshihen në numërorin telefonik, lidhur me qëllimin e numërorit të shtypur ose atij elektronik të parapaguesve në dispozicion për publikun ose të marra përmes shërbimeve të numërorit, në të cilin të dhënat e tyre personale mund të përfshihen dhe për ndonjë shfrytëzim të mëtutjeshëm të mundësive bazuar në funksionet e kërimit të vendosura në versionet elektronike të numërorit.

81.2. Ofruesit e shërbimit duhet të sigurojnë se parapaguesit e kanë mundësinë e përcaktimit nëse të dhënat e tyre personale janë të përfshira në numërorin publik dhe nëse është kështu, cilat, në atë nivel të tillë të dhënave janë relevante për qëllimin e numërorit

siç është përcaktuar nga ofruesi i numërorit dhe t'i verifikojë, përmirësojë ose tërheq të dhënat e tilla. Të gjitha këto që u përmendën më sipër duhet të bëhen pa pagesë.

81.3. Ofruesit e shërbimit mund të kërkojnë që për çfarëdo qëllimi të një numërori publik të ndryshëm nga kërkimi i hollësive të kontaktit të personave mbi bazat e emrave të tyre dhe, kur është e domosdoshme, një minimum të identifikuesve të tjerë, pëlqimin shtesë që do të kërkohej nga parapaguesit.

81.4. Paragrafët (1) dhe (2) aplikohen për të gjithë shfrytëzuesit.

Neni 82 Komunikimet e padëshiruara

82.1. Shfrytëzimi i sistemeve të thirrjeve automatike pa intervenim të njeriut (makinat automatike të thirrjes), makinat e faksimilit (faksi) ose posta elektronike për qëllimet e marketingut të drejtpërdrejtë, mund të lejohen vetëm për parapaguesit të cilët më parë e kanë dhënë pëlqimin.

82.2. Pa marrë parasysh paragrafin (1), ku një person fizik ose juridik merr nga konsumatorët e tyre hollësitë e kontaktit elektronik për postën elektronike, në kuptimin e shitjes së një produkti ose shërbimi, në përputhje me këtë ligj, personi i njëjtë fizik ose juridik mund t'i shfrytëzojë këto hollësi të kontaktit elektronik për marketing të drejtpërdrejtë të produkteve të tyre të ngjashme ose të shërbimeve me kusht që konsumatorëve u është dhënë qartë mundësia që të bëjnë vërejtje, pa pagesë dhe në mënyrë të lehtë, për shfrytëzimin e tillë të hollësive të kontaktit elektronik kur ato janë mbledhur dhe në rastin e secilit mesazh, në rast se konsumatori fillimisht nuk e ka refuzuar shfrytëzimin e tillë.

82.3. Ofruesit e shërbimit duhet të marrin masat e duhura për të siguruar që parapaguesi të komunikojë pa pagesë në rastet e padëshiruara ose për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, në rastet e ndryshme me ato që u referohen paragrafëve (1) dhe (2), qoftë duke mos u lejuar pa pëlqimin e parapaguesve ose sa i përket parapaguesve që nuk dëshirojnë t'i pranojnë këto komunikime.

82.4. Duhet të ndalohet praktika e dërgimit të postës elektronike për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, fshehja ose zhdukja e identitetit të dërguesit ose në emër të cilit është bërë komunikimi, ose pa një adresë valide në të cilën pranuesi mund ta dërgojë kërkesën për ndërprerjen e komunikimeve të tilla.

82.5. Paragrafët (1) dhe (3) duhet të zbatohen për të gjithë shfrytëzuesit.

Neni 83 Karakteristikat teknike dhe standardizimi

Asnjë kërkesë obliguese për karakteristika të veçanta teknike nuk mund të imponohet në terminal ose në një pajisje tjetër të komunikimit elektronik që mund të pengojë vendosjen e pajisjes në treg dhe qarkullimin e lirë të pajisjes së tillë brenda dhe jashtë Kosovës.

PJESA E TETË– NËNSHKRIMET ELEKTRONIKE NË TREGTI

Kapitulli XVII Dispozitat e përgjithshme

Neni 84 Qëllimi dhe fushëveprimi

Ky ligj zbatohet kur nënshkrimet elektronike përdoren për aktivitete komerciale.

Neni 85 Përkufizimi

Për qëllimet e këtij ligji:

“**Certifikata**” do të thotë një mesazh i të dhënave ose shënim tjetër që konfirmon lidhjen ndërmjet nënshkruesit dhe ofruesit të shërbimeve certifikuese.

“**Ofruesi i shërbimeve të certifikimit**” nënkupton subjektin që lëshon certifikata dhe mund të ofrojë shërbime tjera lidhur me nënshkrimet elektronike në bazë të ligjit.

“**Mesazhi i të dhënave**” do të thotë informacionin e krijuar, dërguar, pranuar ose të ruajtur nëpërmjet mjeteve elektronike, optike ose të ngjashme, por jo duke u kufizuar në shkëmbimin elektronik të dhënave -SHEDH, postën elektronike, telegramit, teleksit ose telekopjes.

“**Nënshkrimi elektronik**” do të thotë të dhënat në formë elektronike, të caktuara ose që logjikisht ndërlidhen me mesazhin e të dhënave, që mund të përdoren për të identifikuar nënshkruesin në lidhje me mesazhin e të dhënave dhe të tregojnë miratimin e nënshkruesit për përmbajtjen e informatave në mesazhin e të dhënave.

“**Pala e besueshme**” do të thotë personin që mund të veprojë në bazat e një certifikate ose nënshkrimit elektronik.

“**Nënshkruesi**” do të thotë personin që mban të dhënat për krijimin e nënshkrimit dhe vepron qoftë në emër të vet apo në emër të personit që e përfaqëson.

Neni 86 Trajtimi i barabartë i teknologjive të nënshkrimit

Asgjë në këtë ligj, përveç nenit 88, nuk do të zbatohet në mënyrë të tillë që do të përjashtojë, kufizojë ose shfuqizojë efektet ligjore të çfarëdo metode për krijimin e një nënshkrimi elektronik që përmbush kërkesat e paraqitura në nenin 89 paragrafi (1), ose përndryshe i përmbush kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Neni 87 Interpretimi

87.1. Gjatë interpretimit të këtij ligji, duhet t'i kushtohet rëndësi origjinës së saj ndërkombëtare dhe të nevojës për të promovuar njëtrajtshmërinë në zbatimin e tij dhe zbatimin e besimit të mirë.

87.2. Çështjet që shprehimisht nuk janë të rregulluar me këtë ligj do të rregullohen në pajtim me parimet e përgjithshme në të cilat ky ligj është bazuar.

Neni 88 Ndryshimet me marrëveshje

Dispozitat në pjesën e tetë të këtij ligji mund të përjashtohen, ose ndikimi i tyre mund të ndryshohet me marrëveshje përpos në rastet kur kjo marrëveshje nuk është e vlefshme ose e fuqizuar nga legjislacioni në fuqi.

Kapitulli XVIII Përdorimi i nënshkrimeve në shoqëri

Neni 89 Pajtueshmëria me kërkesën për një nënshkrim

89.1. Kur ligji kërkon një nënshkrim të një personi, ajo kërkesë përmbushet në lidhje me mesazhin e të dhënave nëse përdoret nënshkrimi elektronik, që është i besueshëm aq sa është i përshtatshëm, për qëllimin për të cilin ai mesazh i të dhënave është gjeneruar ose komunikuar, për qartësimin e të gjitha rrethanave, duke përfshirë çfarëdo marrëveshje relevante.

89.2. Paragrafi (1) zbatohet nëse kërkesa e referuar në të është në formë të obligimit ose nëse ligji parasheh pasojat për mungesën e nënshkrimit.

89.3. Një nënshkrim elektronik konsiderohet të jetë i besueshëm për qëllime të plotësimit të kërkesave të referuara në paragrafin (1) nëse:

- a) të dhënat e nënshkrimit të krijuar, brenda kontekstit në të cilin janë përdorur, janë të ndërlidhura me nënshkruesin dhe jo me ndonjë person tjetër;
- b) të dhënat e nënshkrimit të krijuar, në kohën kur nënshkruhen, janë nën kontroll të nënshkruesit dhe jo të ndonjë personi tjetër;
- c) çfarëdo ndryshimi në nënshkrimin elektronik i bërë pas kohës së nënshkrimit dallohet dhe
- d) Kur qëllimi i një kërkesë ligjore për një nënshkrim është që të ofrojë siguri për integritetin e informatës me të cilin ndërlidhen, çfarëdo ndryshimi i bërë në informatë pas kohës së nënshkrimit është i detektueshëm.

89.4. Paragrafi (3) nuk kufizon mundësinë e çfarëdo personi:

- a) për të krijuar në ndonjë mënyrë tjetër, për qëllim të plotësimit të kërkesave të referuara në paragrafin 1, besueshmërinë e një nënshkrimi elektronik; ose

b) që të sjell fakte për jo besueshmërinë e një nënshkrimi elektronik.

89.5. Përveç nëse nuk specifikohet ndryshe në ligjin e zbatueshëm, dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për:

- a) transaksionin e tokës;
- b) shkurorëzimet;
- c) adoptimet;
- d) dëshirën e fundit dhe testamentin.

Neni 90 Zbatimi

90.1. Gjykata Ekonomike e Kosovës mund të përcaktojë cili nënshkrim elektronik i plotëson dispozitat e nenit 89 të këtij ligji.

90.2. Çfarëdo përcaktimi i bërë në paragrafin (1) duhet të jetë në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare.

90.3. Asgjë në këtë nen nuk ndikon në veprimin e rregullave të së drejtës ndërkombëtare private.

Neni 91 Veprimet e nënshkruesit

91.1. Kur të dhënat e nënshkrimit mund të përdoren për të krijuar një nënshkrim me efekt ligjor, secili nënshkrues:

- a) ushtron kujdes të arsyeshëm për t'iu shmangur përdorimit të paautorizuar të dhënave të nënshkrimit të tij të krijuar;
- b) pa ndonjë vonesë të paarsyeshme t'i shfrytëzojë mjetet e vëna në dispozicion nga ofruesi i shërbimeve të certifikimit, në pajtim me nenin 92 të këtij ligji, ose përndryshe bën përpjekje të arsyeshme, që të njoftojë çdo person së cilin në mënyrë të arsyeshme pritet nga nënshkruesi që të mbështetet ose të ofrojë shërbime të përkrahjes së nënshkrimit elektronik nëse:
 - (i) nënshkruesi ka njohuri se të dhënat e nënshkrimit të krijuar janë komprometuar ose
 - (ii) rrethanat e njohura për nënshkruesin paraqesin rrezik thelbësor se të dhënat e nënshkrimit të krijuar mund të janë kompromentuar;
- c) kur certifikata përdoret për mbështetje të një nënshkrimi elektronik, ushtron kujdes të arsyeshëm për të siguruar precizitet dhe kompletim të gjitha prezantimeve të materialit, të bëra nga nënshkruesi janë relevante për certifikatën gjatë tërë ekzistencës së saj ose do të përfshihen më tej në certifikatë.

91.2. Për dështimet e tij/saj për përmbushjen e kërkesave të paragrafit (1) nënshkruesi do t'i bartë pasojat ligjore.

Neni 92
Veprimet e ofruesit të shërbimeve të certifikimit

92.1. Kur ai që ofron shërbimeve certifikimit ofron për ta mbështetur një nënshkrim elektronik, që mund të shfrytëzohen për efekte ligjore si nënshkrim, ofruesi i shërbimeve certifikuese do të:

- a) veprojë sipas prezantimeve të bëra nga ai për sa i përket politikave dhe praktikave të tij;
- b) ushtrojë përkujdesje të arsyeshme, të sigurojë precizitet dhe kompletim të gjitha prezantimeve të materialeve të bëra nga ai , relevante për certifikatë, gjatë tërë ekzistencës së saj ose të atyre të përfshira në certifikatë;
- c) ofrojë mjete të arsyeshme për qasje që i mundësojnë palës së besueshme ta përcaktoj sipas certifikatës:
 - (i) identitetin e ofruesit të shërbimit të certifikimit;
 - (ii) që nënshkruesi i identifikuar në certifikatë ka kontrolluar të dhënat e nënshkrimit të krijuar në kohën kur certifikata është lëshuar;
 - (iii) që të dhënat për nënshkrimit e sajuar janë të vlefshme në kohën ose para kohës kur është dhënë certifikata;
- d) ofrojë mjete të arsyeshme për qasje që i mundësojnë palës së besueshme të përcaktojë nga certifikata apo në mënyrë tjetër, ku është relevante:
 - (i) metoda e përdorur për të identifikuar nënshkruesin;
 - (ii) çdo kufizim me qëllim ose vlerë për të cilën të dhënat e nënshkrimit të krijuar mund të shfrytëzohen;
 - (iii) që të dhënat e nënshkrimit të krijuara janë të vlefshme dhe nuk janë komprometuar;
 - (iv) çdo kufizim për fushëveprimin ose shtrirjen e përgjegjësisë të përcaktuar nga ofruesi i shërbimit të certifikimit;
 - (v) se a ka mjete për nënshkruesin që të njoftojë në pajtim me nenin 91, paragrafi (1) (b), të këtij ligji;
 - (vi) se a është ofruar me kohë shërbimi i revokimit;
- e) kur ofrohen shërbimet në-nën paragrafin (d)(v), ofron mjete për nënshkruesin që të njoftoj në pajtim me nenin 91 paragrafi (1)(b), të këtij ligji dhe kur ofrohen shërbimet në nën paragrafin (d) (vi), sigurohet që të jetë në dispozicion në kohë shërbimi i revokimit;
- f) të shfrytëzoj sisteme të besueshme, procedura dhe resurse njerëzore gjatë kryerjes së shërbimeve të tij.

92.2. Për dështimet e tij/saj për përmbushje të kërkesave të paragrafit (1) ofruesi i shërbimeve të certifikimit do t'i bartë pasojat ligjore.

Neni 93
Besueshmëria

Për qëllime të nenit 92, paragrafi (1)(f) të këtij ligji, qoftë për përcaktimin ose deri në çfarë mase, sistemet, procedurat dhe resurset njerëzore të shfrytëzuara nga ofruesi i shërbimit të certifikimit janë të besueshme, kujdesi mund t'u jepet faktorëve në vijim:

- a) burimet financiare dhe njerëzore duke i përfshirë ekzistimin e aseteve;
- b) cilësia i sistemeve të harduerit dhe softuerit;
- c) procedurave për procesimin e certifikatave dhe aplikacioneve të certifikatave si dhe mirëmbajtja e shënimeve;
- d) informatat që janë në dispozicion për nënshkruesit të identifikuar në certifikata dhe për palët potenciale të besueshme;
- e) rregullsia dhe shtrirja e revizionit nga ana e një organi të pavarur;
- f) ekzistenca e deklaratës nga IPVQ-t, një organ i akredituar ose ofruesi i shërbimit të certifikimit në lidhje me përputhjen ose ekzistimin e atyre më lartë;
- g) çdo faktor tjetër relevant.

Neni 94

Veprimet e palës të besueshme

Për dështimet e tij/saj pala e besueshme do t'i bartë pasojat ligjore:

- a) për të ndërmarr hapa të arsyeshëm për të verifikuar besueshmërinë e një nënshkrimi elektronik; ose
- b) kur nënshkrimi elektronik mbështetet nga certifikata, për të ndërmarr hapa të arsyeshëm:
 - (i) që të verifikojë vlefshmërinë, suspendimin ose revokimin e certifikatës dhe
 - (ii) që të zbatojë çdo kufizim në lidhje me certifikatën.

Neni 95

Njohja e certifikatave dhe nënshkrimeve elektronike të huaja

95.1. Gjatë përcaktimit nëse, apo deri në çfarë mase certifikata ose nënshkrimi elektronik është juridikisht i plotfuqishëm, nuk do të merret në konsideratë:

- a) vendi ku certifikata është lëshuar ose nënshkrimi elektronik është krijuar ose përdorur; ose
- b) për vendin e biznesit të lëshuesit ose nënshkruesit.

95.2. Certifikata e lëshuar jashtë Kosovës do të ketë të njëjtin efekt juridik në Kosovë si certifikatë e lëshuar në Kosovë nëse ofron nivel të barabartë të qëndrueshëm të besueshmërisë.

95.3. Një nënshkrimi elektronik i krijuar ose i përdorur jashtë Kosovës do të ketë të njëjtën fuqi ligjore në Kosovë si nënshkrimi elektronik i krijuar ose i shfrytëzuar në Kosovë nëse ai ofron nivel të barabartë të qëndrueshëm të besueshmërisë.

95.4. Gjatë përcaktimit se a ofron certifikata ose nënshkrimi elektronik nivel të barabartë të qëndrueshëm të besueshmërisë për qëllimet e paragrafit (2) apo (3), në konsideratë do të merren standardet e njohura ndërkombëtare dhe ato të çfarëdo faktorëve të tjerë relevantë.

95.5. Kur përveç paragrafëve (2), (3) dhe (4), palët pajtohen ndërmjet veti, të përdorin llojet eaktuara të nënshkrimeve elektronike ose të certifikatave, ajo marrëveshje do të njihet si adekuate për qëllimet e njohjes jashtë kufijve, përveç nëse ajo marrëveshje nuk do të jetë e vlefshme ose efektive sipas legjislacionit në fuqi.

PJESA E NËNTË –MBROJTJA E SISTEMEVE INFORMATIKE
Kapitulli XIX
Sistemet informatike në shoqëri

Neni 96
Qëllimi dhe fushëveprimi

Objektivë e kësaj pjese të ligjit është ta përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve ligjore dhe autoriteteve të tjera kompetente, duke përfshirë shërbimet e specializuara të zbatimit të ligjit të Kosovës, përmes harmonizimit të rregullave të Ligjit penal në Kosovë në zonën e sulmeve kundër sistemeve informatike dhe transferit të dhënave.

Neni 97
Përkufizimi

Për qëllimet e këtij ligji, përkufizimet në vijim do të zbatohen:

“**Personi i autorizuar**” do të thotë çdo person fizik ose juridik që ka të drejtë, i lejohe me ligj, të përdorë, menaxhojë, kontrollojë, testojë, kryejë hulumtime shkencore legjitime ose ndryshe të operojë një sistem informatik dhe i cili vepron në pajtim me atë të drejtë.

“**Kompjuteri**” do të thotë çdo pajisje ose grup pajisjesh të ndërlidhura ose të ngjashme, nga të cilat një ose më tepër, kryen procesimin automatik të dhënave kompjuterike në pajtim me programin.

“**Të dhënat kompjuterike**” do të thotë çdo paraqitje të fakteve informatike ose të koncepteve që janë krijuar ose vendosur në një formë të përshtatshme për procesim në një sistem informatik, duke përfshirë programin e përshtatshëm që i mundëson një sistemi informatik të kryej një funksion.

“**Përgjimi i të dhënave**” nga aspekti teknik do të thotë qasje në të dhënat kompjuterike të transmetimeve jopublike të ose nga një sistemi informatik.

“**Rrjeta elektronike e komunikimeve**” do të thotë sistemet transmetuese dhe kur janë të zbatueshme, pajisjet për komutim ose rutinim dhe burimeve të tjera që lejojnë bartjen e sinjaleve me anë të telit, të radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetat satelitore, fikse (qark- dhe paket-komutimi, duke përfshirë internetin) dhe rrjetet mobile tokësore, sistemet e kablllove elektrike, deri në masën që ato janë të shfrytëzueshme për qëllim të transmetimit të sinjaleve të rrjeteve të përdorura për radio dhe transmetimet televizive, rrjetave e kablllove të televizionit, pavarësisht nga lloji i informatës që bartet.

“**Sistemi informatik**” do të thotë rrjetet kompjuterike dhe rrjetet e komunikimit elektronik si dhe të dhënat që ruhen, procesohen, korrigjohen, apo transferohen nga kompjuterët për qëllime të operimit, përdorimit, mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së tyre.

“**Personi Juridik**” do të thotë çdo entitet i cili ka status të tillë sipas ligjit të zbatueshëm, përveç organeve shtetërore ose të organeve tjera publike që ushtrojnë autoritetin shtetëror dhe për organizatat publike ndërkombëtare.

“**Pa të drejtë**” nënkupton përjashtimin e sjelljes se personave të autorizuar apo sjellje të tjera të njohura si të ligjshme sipas ligjit vendor.

Neni 98
Qasja ilegale në sistemet informatike

98.1. Qasja me qëllim, pa të drejtë, në ndonjë pjesë ose në tërë sistemin informatik konsiderohet si vepër penale kur ajo bëhet:

- a) kundër ndonjë pjese të një sistemi informatik që i nënshtrohet masave specifike të mbrojtjes;
- b) me qëllim të shkaktimit të dëmit në personin fizik ose juridik;
- c) me qëllim të përfitimit ekonomik.

98.2. Dispozitat e paragrafit (1) në veçanti zbatohen lidhur me përgjimin e të dhënave.

Neni 99
Ndërhyrja ilegale në sistemet informatike

Sjellja me qëllim, pa të drejtë, si në vijim, do të konsiderohen si vepër penale:

- a). pengimi ose ndërprerja serioze e funksionimit të një sistemi informatik duke hyrë, transmetuar, dëmtuar, fshirë, prishur, ndryshuar, shtypur ose duke interpretuar të dhënat kompjuterike të pa qasshme;
- b). fshirja, prishja, ndryshimi, shtypja ose interpretimi i të dhënave kompjuterike të pa qasshme në një sistem informatik, kur bëhet me qëllim të shkaktoj dëm personit fizik ose juridik.

Neni 100
Nxitja, ndihma, shtyrja dhe tentimi

100.1. Nxitja me qëllim, për të ndihmuar ose shtyrë një shkelje që referohet në nenin 98 dhe 99 është e dënueshme.

100.2. Çdo tentim për të bërë shkeljet e paraqitura në nenin 98 dhe 99 është e dënueshme.

Neni 101
Dënimet

101.1. Shkeljet që referohen në nenet 98, 99 dhe 100 dënohen më dënime, duke përfshirë dënimin me burg me kohëzgjatje maksimale të burgimit jo me pak se një vit për rastet serioze, me përjashtim të rasteve kur pas hetimeve rezulton se rastet nuk kanë qenë të dëmshme ose kanë sjell përfitim ekonomik, janë raste serioze

101.2. Gjykata Ekonomike e Kosovës mund të caktojë gjoba të tjera. përveç ose si alternativë e dënimit me burg.

Neni 102
Rrethanat rënduese

102.1. Shkeljet që referohen në nenet 98, 99 dhe 100 dënohen me burg me kohëzgjatje maksimale të burgimit me jo më pak se katër (4) vjet kur ato kryhen nën këto rrethana:

- a). shkelja është bërë përbrenda kornizës së një organizate kriminale siç përkufizohet në veprimin e përbashkët të Bashkimit Evropian 98/733/ JHA të 21 dhjetorit 1998 që e bën vepër penale pjesëmarrjen në një organizatë kriminale në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, përveç lartësisë së dënimit që i referohet këtu;
- b). shkelja ka shkaktuar ose ka rezultuar në, humbje të konsiderueshme ekonomike të drejtpërdrejt ose të tërthortë, dëmtim fizik të personit fizik ose dëmtim të konsiderueshëm në pjesë të infrastrukturës kritike të Kosovës;
- c). shkelja ka rezultuar mbi të hyra të konsiderueshme.

102.2. Shkeljet që referohen në nenet 98 dhe 100 dënohen me burgim më të lartë se ato të parapara në nenin 101, kur shkelësi është dënuar për shkelje të tilla me gjykim të prerë, nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë.

Neni 103 Rrethanat e veçanta

Pavarësisht neneve 101 dhe 102, dënimet që referohen në nenin 101 dhe 102 mund të zvogëlohen, kur, mendimi i autoritetit gjyqësor kompetent, është që shkelësi ka shkaktuar vetëm dëme të vogla.

Neni 104 Përgjegjësia e personave juridikë

104.1. Personi juridik mund të konsiderohet përgjegjës për sjelljet, që referohen në nenin 98, 99 dhe 100, të kryera për përfitimin e tyre nga çdo person që vepron qoftë individualisht ose si pjesë e një organi të personit juridik, i cili ka pozitë udhëheqëse brenda personit juridik, bazuar në:

- a) autoritetin për përfaqësim e personit juridik,
- b) autoritetin që të merr vendime në emër të personit juridik, ose
- c) autoritetin që të ushtrojë kontroll përbrenda personit juridik.

104.2. Përveç rasteve të paraqitura në paragrafin (1), personi juridik mund të konsiderohet përgjegjës kur mungesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga ana e personit të referuar në paragrafin 1, ka bërë të mundur kryerjen e shkeljeve që referohen në nenin 98, 99 dhe 100, për përfitim të personit juridik nga personi nën autoritetin e tij.

104.3. Përgjegjësia e personit juridik në paragrafin (1) dhe (2) nuk do të përjashtojë procedurat penale ndaj personave fizikë që kryejnë shkelje ose kyçen në sjelljet që referohen në nenet 98, 99 dhe 100.

Neni 105 Sanksionet për persona juridikë

105.1. Personi juridik që konsiderohet përgjegjës sipas nenit 104 paragrafi (1) dënohet me sanksione efektive, proporcionale dhe imponuese, në të cilat përfshihen dënimet penale dhe jo penale dhe mund të përfshijë sanksionet tjera siç janë:

- a) përjashtimi nga e drejta për përfitime ose ndihma publike;
- b) diskualifikimi i përkohshëm ose i përhershëm nga praktika e aktiviteteve komerciale;

- c) vendosja nën mbikëqyrje juridike; ose
- d) urdhri juridik për mbyllje.

105.2. Personi juridik që konsiderohet përgjegjës në pajtim me nenin 104 paragrafi (2) dënohet me sanksione ose masa efektive, proporcionale dhe imponuese.

Neni 106 Juridiksioni

106.1. Gjykata Ekonomike e Kosovës do ta ketë juridiksionin kryesor që ka të bëjë me shkeljet që referohen në nenin 98, 99 dhe 100 kur shkelja bëhet:

- a) në një pjesë ose në tërë, Kosovës; ose
- b) nga banori i Kosovës dhe veprimi i tij dëmton individët ose grupet brenda Kosovës; ose
- c) për të mirën e një personi juridik që e ka zyrën kryesore në Kosovë.

106.2. Juridiksioni i krijuar në pajtim me paragrafin (1) (a) do të përfshijë rastet kur:

- a).shkelësi bën shkeljen kur fizikisht është prezent në Kosovë, pavarësisht se shkelja bëhet ose nuk bëhet kundër një sistemi informatik të Kosovës; ose
- b).shkelja është kundër një sistemi informatik në Kosovë, pavarësisht se a e ka bërë shkelësi shkeljen kur fizikisht ka qenë i pranishëm në Kosovë;

106.3. PSSP ka autoritetin final për shkeljet që referohen në nenet 98, 99 dhe 100 në rastet kur Gjykata Ekonomike e Kosovës refuzon ta dorëzojë ose ekstradojë personin e dyshuar ose të dënuar për një shkelje të tillë në vendin e tretë.

106.4. Kur një shkelje bie nën juridiksionit e më shumë se një vendi dhe kur cilido prej këtyre juridiksioneve të brengosura mund që në mënyrë valide të ndjek penalisht, duke u bazuar në fakte të njëjta, atëherë Gjykata Ekonomike e Kosovës duhet të bashkëpunojnë dhe të konsultohet me PSSP, në mënyrë që të vendosin se kush prej tyre do të ndjekë penalisht shkelësit, me qëllim që dhe nëse është e mundur të bëhet centralizimi i procedurave nën një juridiksion të vetëm. Përfundimisht PSSP mund të zgjedhë çfarëdo organi ose mekanizëm të themeluar nga Bashkësia Evropiane, në mënyrë që të mbështes bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të tyre juridike dhe bashkërendimin e veprimit të tyre.

Neni 107 Shkëmbimi i informatave

Me qëllim të shkëmbimit të informatave në lidhje me shkeljet që referohen në Nenin 98, 99, dhe 100 dhe në pajtim me ligjin e zbatueshëm dhe me rregullat për mbrojtjen e të dhënave, Gjykata Ekonomike e Kosovës do t'i themelojë pikat operacionale për kontaktim në dispozicion 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë.

Neni 108
Implementimi i ligjit

Autoriteti kompetent mund të nxjerrë udhëzime administrative për zbatimin e këtij ligji.

Neni 109
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pasi ta ketë miratuar Kuvendi i Kosovës dhe pasi ta ketë shpallur Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-23
22 korrik 2005

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Akademik Nexhat Daci